



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 18 DHE 25 MAJ 2016**

**SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 18. I 25. MAJA 2016. GODINE**

**MAJ - MAJ
2016**

Rendi i ditës

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme,
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-093 për ratifikimin e Konventës për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja (5 tetor 1961),
5. Votimi i Projektligjit nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-064 për patentë-shofer,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 05/L-55 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës,
8. Votimi i anëtarëve të Bordit Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit,
9. Votimi i raportit të Komisionit për Integritet Evropian lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale,
10. Votimi i raportit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-032 për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës,
11. Votimi i raportit të performancës së ndërmarrjeve publike për vitin 2014,
12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-96 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit,
13. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës,
14. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit për Ankesa të Medieve,
15. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2015,
16. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2015,
17. Shqyrtimi i raportit financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015,
18. Shqyrtimi i raportit të punës së Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2015,
19. Shqyrtimi i raportit të punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2015,
20. Shqyrtimi i raportit të punës së Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2015.

Dnevni red

1. Vreme za izjave van dnevnog reda,
2. Vreme za parlamentarna pitanja,
3. Usvajanje zapisnika sa prethodnih sednice,
4. Razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-093 o potvrđivanju Konvencije o ukidanju zahteva za legalizaciju stranih zvaničnih dokumenata (5. oktobar 2061.)
5. Glasanje Nacrta zakona br. 05/L-095 o Akademiji pravde,
6. Drugo razmatranje N/zakona br.05/L-064 o vozačkoj dozvoli,
7. Drugo razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-55 o Generalnom revizoru i Nacionalne kancelarije za reviziju u Republiku Kosova,
8. Glasanje o izboru članova Savetodavnog borda za zaštitu životne sredine,
9. Glasanje izveštaja Komisije za evropske integracije o nadgledanje sprovođenja Zakona o proširenim nadležnostima za konfiskaciju imovine stečene vršenjem krivičnih dela,
10. Glasanje izveštaja Komisije za obrazovanje, nauku, tehnologiju, kulturu, omladinu i sport u vezi nadgledanja Zakona br. 04/L-032 o preduniverzitetskom obrazovanju u Republici Kosova,
11. Glasanje izveštaja performanse javnih preduzeća za 2014. godinu,
12. Prvo razmatranje Nacrta zakona br. 05/L-96 o sprečavanju pranja novca i borbe protiv finansiranja terorizma,
13. Razmatranje Predlog odluke Vlade Republike Kosova za imenovanje članova Komisije za zaštitu konkurencije,
14. Formiranje ad-hoc Komisije za izbor članova Odbora za žalbe medija,
15. Razmatranje Izveštaja Agencije za besplatnu prvanu pomoć za 2015.
16. Razmatranje Izveštaja Državne agencije za zaštitu ličnih podataka za 2015.
17. Razmatranje Godišnjeg finansijskog izveštaja o Budžetu Republike Kosova, za 2015. godinu,
18. Razmatranje Godišnjeg izveštaja o radu Nezavisne Komisije za rudnike i minerale, za 2015. godinu,
19. Razmatranje Godišnjeg izveštaja o radu Agencije protiv korupcije, za 2015. godinu.
20. Razmatranje Godišnjeg izveštaja o radu Autoriteta za civilnu avijaciju, za 2015. godinu.

Mbledhjen e drejtoi kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
I nderuar kryeministër,
Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra të Kabinetit qeveritar,
I hap punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Koha për deklarime jashtë rendit të ditës është e kufizuar deri në 30 minuta, diskutimi në emër të grupit parlamentar zgjat deri në pesë minuta, ndërsa diskutimi i deputetit deri në tre minuta.

Deputetët e paraqitur për diskutim duhet të deklarohen se në çfarë cilësie e kërkojnë fjalën.

Atëherë Bekim Haxhiu e ka fjalën në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës. Janë 7 veta të lajmëruar, a ka të tjerë? LDK-ja nuk ka, në qoftë se nuk ka, atëherë “6+” si grup parlamentar, Duda Balje le të bëhet gati.

BEKIM HAXHIU: I nderuar kryetar i Kuvendit,
I nderuar kryeministër,
Kabinet qeveritar,
Të nderuar kolegë deputetë,
Të nderuar sportistë dhe sportdashës të Republikës së Kosovës,
Sot kam nderin dhe privilegjin e papërsëritshëm që në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, në cilësinë e deputetit dhe kontribuuesit të sportit të ju uroj të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës pranimin e Federatës së Futbollit të Kosovës në UEFA dhe në FIFA.

Ky është sukses, i cili u bë i mundur falë punës së shkëlqyeshme të kryetarit Fadil Vokrri dhe të gjithë anëtarëve të Komitetit Ekzekutiv të Federatës së Futbollit të Kosovës.

Para se t'i them disa fjalë për rëndësinë e anëtarësimit të futbollit tonë në UEFA dhe në FIFA, nuk mund ta anashkaloj këtë moment festiv pa dallime partiake, nuk mund ta anashkaloj krenarinë që e kemi ndier të gjithë në këtë moment historik për futbollin e Kosovës.

Shumë gjenerata janë venitur duke qenë të robëruar, e më pas edhe të izoluar. Kam emocione të veçantë sot kur flas për anëtarësimin tonë në UEFA dhe në FIFA, sepse futbollistët tanë janë të veçantë. Ata nuk e derdhën vetën djersën e tyre në fushat e blerta, por kur ishte nevoja ata e kundërshtuan një sistem të tërë. E sakrifkuan karrierën e tyre të bujshme sportive për idealin e lirisë dhe të pavarësisë. Ata dhanë edhe më shumë, ranë në fushat e nderit, në vijat e fronit, nën emblemën e shenjtë të UÇK-së me idealin e lirisë që pas tyre në fushat e blerta të lozin të lirë fëmijët e Kosovës.

Sot shumë arena sportive e stadiume futbolla i bartin me nder emrat e futbollistëve heronj, emra të cilët do të lartësohen edhe më lart në piedestalet e sportit ndërkombëtar.

Puna e bërë në Federatën e Futbollit të Kosovës është dëshmia më e mirë se përveç vizionit duhet edhe shumë punë, përkushtim e sakrificë për t'i realizuar qëllimet.

Puna e vazhdueshme me një strategji të qartë deri në anëtarësimin e plotë të FFK-së në UEFA dhe në FIFA ka kërkuar një angazhim maksimal të çdo anëtari të FFK-së.

Prandaj, sot me respekt të veçantë për punën e tyre, të bërë me dekada të emrave të ndritur të futbollit të Kosovës, në veçanti të kryetarit Fadil Vokrri, të futbollistëve dhe donatorëve, të cilët asnjëherë nuk u ndalën së punuari, por bënë të mundur që topi të rrokulliset në fushat e blerta të Kosovës dhe mundësuan të lëvizë përpara edhe në këtë rajon për të qenë pjesë e futbollit evropian dhe ndërkombëtar.

Të nderuar kolegë,

Muajin maj 2016 do ta shënojmë si një muaj të anëtarësimit dhe integritit, duke përfshirë këtu pranimin në UEFA dhe në FIFA dhe liberalizimin e vizave.

Është një rekapitullim i një pune të suksesshme të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve sportive dhe dikastereve qeveritare të mandatit të kaluar dhe këtij të tanishmit.

Andaj, e shfrytëzoj rastin t'i falënderoj ministrat Memli Krasniqi edhe Kujtim Shala, kryeministrin Isa Mustafa dhe presidentin Thaçi për gjithë mbështetjen që i dhanë Federatës së Futbollit të Kosovës dhe kryetarit Fadil Vokrri për ta finalizuar përpjekjen shumëvjeçare të shumë gjeneratave.

Prania në Budapest e ish-kryetarëve të FFK-së Agim Bytyçi dhe Sabri Hashani, në kuadër të delegacionit të FFK-së, është dëshmia më e mirë se sa herë e vlerësojmë kontributin e njerëzve meritorë ne do të arrijmë t'i realizojmë objektivat e së ardhmes.

Ky model i punës të Fadil Vokrrit dhe FFK-së duhet të ndiqet edhe nga shumë bartës të institucioneve publike, qeveritare dhe lokale në subjekte politike apo organizata punonjëse kudo për të punuar me pozitivitet për të mirën e vendit.

Të nderuar deputetë,

Anëtarësimi në UEFA dhe në FIFA e hap një perspektivë të re për rininë tonë, për futbollistët, do të sjellë edhe përfitime direkte dhe indirekte, do të ndikojë në ngritjen e imazhit të Kosovës në arenën ndërkombëtare dhe shumë benefite të tjera, do të na sjellë edhe shumë emocione, por kjo kërkon edhe përgjegjësi, punë të mëtutjeshme edhe më të madhe se deri më sot për t'u dalë në ballë përgjegjësi që kemi marrë karshi UEFA-s dhe FIFA-s.

Ne duhet ta ngremë nivelin e infrastrukturës sportive. Ta përfundojmë renovimin në stadiumin "Adem Jashari" dhe në Stadiumin e Prishtinës sipas standardeve të UEFA-s dhe FIFA-s, dhe të fillojmë së ndërtuari stadiumin nacional për Kombëtaren e Kosovës.

Të përshpejtojmë miratimin e ligjeve që do të mundësojnë avancimin e futbollit dhe të sportit, në përgjithësi.

Kuvendi i Kosovës në muajin shkurt të vitit 2013 e ka bërë një debat për sportin dhe ka nxjerrë disa rekomandime, e ndër to Ligjin për sponsorizim, Ligjin kundër huliganizmit dhe Ligjin për menaxhimin e objekteve sportive dhe sigurinë e tyre.

Deri më tani, në Kuvend na ka arritur vetëm Ligji për sponsorizime dhe në formën si ka ardhur ai nuk përmbush as pritjet e sponsorëve, e as të klubeve, e as nuk do të mund të bëjë ndonjë avancim më të mirë të sportit.

Andaj, të nderuar, kërkoj angazhimin e të gjitha grupeve parlamentare pa dallim, pozitë e opozitë, për t'i arritur objektivat tona, për t'u hapur rrugë të reja sportistëve. Ne duhet ta përmirësojmë infrastrukturën sportive, t'i miratojmë ligjet e duhura, që rinisë tonë, futbollistëve dhe sportistëve, t'ua hapim rrugën që ta realizojnë ëndrrën e tyre që një ditë të jenë kampionë Evropë, apo bote...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, të lutem mos ua ndal kurrë fjalën deputetëve sa të jem unë kryetar.

BEKIM HAXHIU: ... që ta valojnë sa më lart flamurin e Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Të nderuar kolegë,

Anëtarësimi në UEFA dhe në FIFA dhe liberalizimi i vizave hap shtigje të reja për rininë tonë. Çdo futbollist yni do ta ketë mundësinë që lirshëm të sprovohet në cilëndo klub evropian. Do ta shohë nga afër cilëndo lojtar të preferuar të tij, apo do të jetë ai lojtar i preferuar në klubet evropiane dhe botërore.

Krejt në fund, e kam një porosi për të gjithë ata futbollistë të Kosovës dhe me origjinë nga Kosova që sot luajnë në përfaqësuesit e shteteve të tjera: Nga sot, vendi juaj është në Federatën e Futbollit të Kosovës, në përfaqësuesen e saj. Atyre që të luajnë në Kampionatin Evropian u dëshirojmë suksese në cilindo përfaqësuese që janë, por menjëherë pas kësaj vendi i tyre është në Përfaqësuesen e Kosovës. Nëse ndonjëri nga anëtarët ka dilema për të vendosur, unë i ftoj që vetëm për një moment të mendojnë dhe të rikujtojnë se sa futbollistë e shuan karrierën e tyre, sa futbollistë i humbën gjymtyrët e tyre në istikame, sa futbollistë e dhanë jetën e tyre, ranë dëshmorë që Kosova të jetë e lirë dhe e pavarur.

U takon futbollistëve më të mirë të Kosovës, kudo që janë në botë, që flamurin e Kosovës ta valojnë sa më lart në arena sportive për t'i nderuar të gjithë të rënë, për t'i vlerësuar dhe nderuar vuajtjet dhe sakrificat edhe të familjeve të tyre dhe gjithë popullit të Kosovës, dhe për një çështje edhe më madhore - për të hapur rrugën e së ardhmes për rininë tonë, për gjeneratat që po vijnë.

Prandaj, ju them Kosova ju thërret, Kosova ju pret. Faleminderit Fadil Vokrri, faleminderit bashkëpunëtorë nga Federata e Futbollit të Kosovës. Suksese! Na priftë e mbara!

KRYETARI: Faleminderit! Duda Balje e ka fjalën, le të bëhet gati Nenad Rashiqi.

DUDA BALJE: Zahvaljujem!

Poštovani poslanici,

U poslednjim danima u Bošnjačkoj zajednici opštine Prizren imali smo dosta napetu situaciju oko izgradnje hidrocentrale, odnosno oko tri zahteva koja su već bila u proceduri za izgradnju hidrocentrala u selima u Župi.

Nakon posete tergeritanim selima u kome se one trebale da se grade nakon javnih debata koje smo imali, i ovom prilikom se zahvaljujem gospodina Arbenu Čitaku i ministru Feridu Agani koji su došli da posete naš teren.

Konstatovali smo da je u više slučajeva bio prekršena i zakonska procedura i iskorišćene neke naše ličnosti iz Bošnjačke zajednice. Posle svih informacija prikupljenih i preko svega što smo razgovarali od strane naše političke partije upućen je zahtev ministarstvu da se prekine procedura za izgradnju ovih hidrocentrala, zahtevi kod ministre. Ja ovim putem apelujem i na ministri i na sve kompetentne institucije da se takva procedura prekine, jer je Bošnjački narod u opštini Prizren jasno rekao da je protiv izgradnje hidrocentrala. Hvala!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Xhavit Haliti.)

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rashiq e ka fjalën, në emër të grupit.

NENAD RAŠIĆ: Hvala gospodine predsedavajući!

Poštovani premijeru,

Poštovani ministri,

Ja sam javio zbog ja mislim jedne velike opasnosti koja se sprema pogotovo penzionerima jer mislim da je došlo do kršenje Zakona u pravima penzionera, a to ću vam objasniti zbog čega.

Kao što verovatno već znate dosada je kosovski penzioni sistem baziran na tri stuba, koji funkcioniše na način koji bi jedan u prvom pilaru trebalo bi sistem da obezbedi priloge, odnosno obezbedi te beneficije penzionerima, koja bi bila minimalna, ali svim što ova druga dva pilara možda da se vremenom to podiže.

I kao jedna informacija, kao što znate, te osnovne ili bazične penzije takozvane na Kosovu su 75 evra, socijalno staranje ili socijala ukupno zbiru u proseku negde je 66 evra, zavisno od broja članova porodice, socijalna 40 do 120 evra.

Tako da recimo 40 ima njih dvoje dva supružnika ukoliko ispunjavaju usluge za socijalu, 120 evra imaju supružnici, ili porodica sa 7 i više članova porodice.

Ali, šta sam hteo da kažem? Zakon o penzijskim šemama finansirane od države koje naravno uvek utvrđuje kriterijumi i pravila kako se dolaze do neke penzije. I moraću da citiram, da vam kažem šta kaže Zakon o penzijama.

Uslovi i kriterijumi za priznavanje penzija na osnovu starosni penzije:

1. Osnovna stopa penzija će se isplatiti svim licima stranim državnima Republike Kosova, licima kojima imaju dokumenta i koja su navršilo 65. godina starosti.

Neobuhvatna važeća dokumenta za priznavanje pravo na osnovnu starosnu penzije su:

1. lična karta izdata od nadležnih organa Kosova.
2. potvrda civilne kancelarije da je stalni stanovnik na određenoj adresi.

Pored toga, obrazac za aplikaciju za penziju i bankovni račun jedne od banaka koje rade na Kosovu.

To su osnovni i jedini kriterijumi koji se utvrđuju za dobijanje starosne penzije, ili bazične penzije.

Ali pre nekoliko dana usvojeno je administrativno uputstvo takozvano 07/15 od strane Ministarstva za rad koji ne da osporava kriterijume, nego faktički i proširuje, gde kaže: imenujući Zakone na način, izvinite što ovako prikazuje zbog toga što jedva došao do ovih informacija. Pored ovih stvari koje sem naveo, lična karta, dokaz za starost 65. Godina, javili se i novi kriterijumi koji naglašavaju svoje u administrativnu uputstvu, a u Zakonu ih nema, gde pored ovih dodatnih, pored ovih postojeći, kaže:

U tački 2.5, jedan od dokaza za račune koji su u njegovo ime za poreznu imovinu, električnu energiju, vode i smeđ, pa ide čak i dalje.

Kako dodat, opet naglašavam, u administrativnom uputstvu. Kaže drugi mogući dokazi potrebni od odgovornih službenika relevantne penzijske kancelarije.

3. Odgovornih penzijskih službenici imaju pravo da traže dodatne dokumenta kao što je navedeno u ovom uputstvu i za sadašnje korisnike penzija.

Ja prvi put vidim da jedno administrativno uputstvo ima veći značaj, proširuje kriterijume ili preduslove za dobijanje penzije.

Ovo administrativno uputstvo o kome pričam je nelegalno, i ono sigurno da krši Zakon. I čisto da bi pojasnio prostim rečnikom: Zakon je baza ili temelj za bilo koje beneficije ili prava, administrativno uputstvo je pojašnjene tih prava, ništa više od toga. Ne može uputstvo od strane jedne ministarstva nadmaši Zakon i da prošire kriterijume.

Još jedan stvar koji će ubrzo doći nama na dnevni red, to je takozvani plan za regulisanje polja penzija, tako se bar on zove, koji je usvojen u Vladi pre nekih mesec i po dana, a još nije došao na dnevni red, ali će verovatno doći.

I moje najveća razočaranje to što je na Vladi usvojen jednoglasno, što niko čak nije o tome nije polemisaio, ili postavio pitanje, i uglavnom o tom planu ima tri tačke ili tri pravce. E taj plan kada bude došlo treba da znate da će biti protiv Ustava i biće protiv ljudskih prava. Razgovaraćemo o

njemu više kad bude došao. A cilj tog uputstva i tog plana, koji će kasnije doći, je navodno kao što kažu ušteda nekih deset miliona evra u budžet Kosova, zbog onih koji, opet navodno, zloupotrebljavaju budžet Kosova, u ovom slučaju penzioneri, koji dobiju po 75 evra penzije.

E sada, ako je stvarno došlo dotle da u regionu, siguran sam, pa čak i u svetu, Kosovo je najniže za penzije, najniže beneficije za penzije, i ukoliko je došlo da od 75 evra penzija uštedimo 10 miliona, ili bilo šta, a ne može uštediti ta cifra, onda ja ne znam šta drugo da kažem osim da je to vrlo apsurdno, pa čak moram da kažem i morbidno.

Ja želim da prenesem svim penzionerima, jer sam to već čuo zadnjih 15-tak dana, jer se ovo administrativno uputstvo već implementira, gde sam čuo različite ljude sa različitim negodovanjima, a neki su vrlo očajni zbog toga što im je uskraćen jedini izvor prihoda, ja moram da prenesem njima da ne smeju da se brinu i da se ne brinu, jer ovo je, kao što sam rekao, protivzakonito i ovo će morati biti osporeno.

Ja hoću da kažem, da zamolim ovom prilikom i premijera i ministra Financija, u ime penzionera, ja vas molim da razmotrite, analizirate, dopunite, dogradite... kako god, i ovo uputstvo i onaj plan koji je predložen, da ne bi došli u situaciju gde je previše kasno i gde opet, kao po starom dobrom običaju, penzioneri budu krivi. Mogu da idem čak i korak dalje, ako mi dozvolite, da vam kažem kako možete rešiti problem penzionera, koji eventualno ne žive na Kosovu. Postoji sistem u Evropi vrlo razvijen, koji se zove, ako se ne varam sada, "general network operation". To je generalna mreža umreženih sistema u cilju informisanja da li je neki određeni penzioner, koji je radio recimo...

KRYESUESI: E ke kaluar për dy minuta kohën. Të lutem, përmyllë diskutimin!

NENAD RAŠIĆ: Po, faleminderit!

Recimo, ako je neko od nas radio u Švajcarskoj 2 godine, pa je radio u Belgiji 3 godine, i on dođe na Kosovu i hoće da prima penziju. U toj generalnoj mreži imate sve podatke gde ste radili. I vi kao institucija imate pravo posle toga da tražite kompenzaciju za taj broj godina koji ste vi proveli tamo. E, sad vam je čak šta više i najbolja prilika. Od momenta potpisivanja Sporazuma za stabilizacije i podučivanje, to je izuzetna šansa da u vrlo kratkom vremenskom periodu utvrdite taj sistem, gde neće niko biti oštećen, gde ćete na legalan način uštedeti novac, i takođe pokazati da jesmo institucije za koje se deklariramo da jesmo, demokratske, pravne i bazirane na poštovanju ljudskih prava. Ovako, na ovaj način, ja se plašim da ćemo samo izazvati kontraefekat, još socijalnih neprilika, i čak šta više dugogodišnju i dugoročnu diskriminaciju prema penzionerima.

Tako da još jednom ja vas molim, da ne bude kasno da razmotrite, pregledate, analizirate, utvrdite šta se drugačije može uraditi osim toga da ne jednostavan način odbijamo naše penzionere. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Rashiq, në qoftë se jeni në grup, duhet të deklarohet grupi dhe të mos abuzoni në emër të grupit, meqenëse s'keni grup parlamentar. Të lutem! Unë këtu të kam pa grup parlamentar. Rregullojeni, ose futu në grup parlamentar!

Atëherë, fjalën e ka zoti Agim Aliu. Ju lus që ta zbatojmë Rregulloren në foltore, deputetët i kanë 3 minuta, përfaqësuesit e grupeve parlamentare 5 minuta.

Kryetari po toleron kur është interes i madh, se përnjëmend fjala e Rashiqit ishte interesante për ta dëgjuar, por... Zoti Aliu, e keni fjalën!

AGIM ALIU: I nderuar nënkryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
I nderuar kryeministër dhe të nderuar ministra të Qeverisë së Republikës së Kosovës,
Të nderuar deputetë,
Këtyre ditëve, respektivisht java e parë e muajit maj ishte ashtu siç foli edhe parafolësi, vërtet një javë historike, një muaj historik për Kosovën, ku ne të gjithë ju gëzuar lajmeve që i pritëm gjatë, lajmeve që dhanë dëshminë se edhe ne jemi të merituar për të qenë krahë për krahë me kombet tjera të Evropës, sepse ne jemi Evropë dhe rrënjët tona janë pjesë e këtij civilizimi.

Sigurisht se presim edhe në të ardhmen e afërt edhe lajme të tjera të mira, që japin edhe më shumë shpresë për qytetarët tanë, por me këtë rast dua të shpreh dilemën time, se sa ne jemi vërtet të përgatitur, që tu përgjigjemi kërkesave dhe obligimeve që dalin si rezultat i këtyre anëtarësimeve në këto institucione evropiane dhe globale, siç bie fjala pranimi në UEFA dhe FIFA dhe a kemi bërë atë që është dashur ta bëjmë në mënyrë që të ishim plotësisht të gatshëm pas këtij anëtarësi. Unë e di që nuk është bërë mjaftueshëm dhe ka ende për tu bërë që kjo infrastrukturë sportive të jetë në nivele që kërkohet për gara të tilla, por besoj se edhe pse jemi vonuar paksa, duhet të mobilizohemi të gjithë që pranime të tilla ndërkombëtare të na gjejnë me kapacitete dhe infrastrukturë adekuate për ngjarje të tilla.

Një ditë e tillë erdhi për futbollin kosovar dhe për këtë duhet përgëzuar Federatën e Futbollit të Kosovës dhe të gjithë qytetarët tanë, por ne presim që ditë të tilla të mira të kemi edhe në të ardhmen dhe duhet të bëhemi më gati, sepse kemi edhe synime të tjera për tu bërë pjesë e këtyre institucioneve politike, ushtarake, sportive e kulturore të Evropës dhe përtej saj.

Ditë më parë, këtu në Kuvend u ngrit çështja në një kontest tjetër e paraqitjes të flamurit tonë në mënyrë jo të dinjitetshme dhe të papranueshme në Festivalin e Evropëvizionit e që meritoi reagim më të fuqishëm nga ana jonë. Unë po shtroj pyetjen, çfarë jemi duke bërë që flamuri ynë të jetë brenda dhe krahë për krah kombeve të tjera evropiane dhe jo të jetë një flamur i ndaluar dhe më shumë se kaq. A jemi duke u përgatitur se si të përfaqësohemi, në ç' mënyrë ne do të përzgjedhim artistët tanë, që të përfaqësojnë Republikën tonë, sepse artistët tanë tashmë kanë dëshmuar se janë të denjë për këtë lloj gare dhe këtë lloj përfaqësi.

Me këtë rast le të më lejohet të pyes, se a kemi ne një festival garues në nivel të Republikës, që do të mundësonte pastaj fituesin të marrë pjesë në këtë eveniment evropian? Ne nuk e kemi dhe edhe pse do të duhej ta kishim një festival të tillë, madje edhe vetëm për konsum kombëtar, e ku do të shfaqeshin vlerat e artistëve tanë të shumtë, që po kanë rezultate kulmore kudo. Ne dikur kishim një festival të tillë dhe ai quhej "Akordet e Kosovës". Ku është ai sot? Pse nuk aktivizohet pas kaq vitesh lirie e pavarësie? Ky festival do të duhej të ishte një prej emblemave tona kulturore, prandaj kërkoj nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe nga Qeveria e Republikës së Kosovës, që të fillojnë me sigurimin e të gjitha parakushteve, që ky festival të fillojë dhe të vazhdojë traditën e tij të bujshme. Shpesh nga institucionet tona janë ndarë mjete

buxhetore për gjëra e projekte koti. Dhe, sikur kësaj i bie tamam ajo thënia e shkrimtarit anglezo-irlandez Oskar Wild, “Ne e dimë çmimin e çdo gjëje, por vlerën e asgjëje”.

Prandaj, t’i mbështetim Akordet e Kosovës, pastaj për Eurovizion do të jemi gati. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Rexhepi e ka fjalën.

EMILIJA REDŽEPI: Hvala gospodine predsedavajući!

Poštovani premijeru,

Vladin Kabinet,

Poštovane kolege poslanici,

Ovim putem izražavam veliko nezadovoljstvo Bošnjačkog naroda koji živi u regionu Prizrena, odnosno Župskom kraju. Na nedavna dešavanja poput početka izgradnje hidrocentrala.

Stojim ispred svog naroda i Ministarstva za Ambijent i Prostorno Planiranje a pre svega Skupština opštine Prizren, odnosno Direktorat za Urbanizam moraju znati da je Zakon iznad svih nas i pozivam istražne organe da pokrenu proceduru povodom ovoga smatrajući da je prekršen Zakon odnosno Ustav Republike Kosova, koji govori da bez transparentnosti, bez organizovanja javnih debata, bez procedure Skupštine Opštine Prizrena nijedna saglasnost niti jedna dozvola može se dati za izgradnju Hidrocentrala. Ja ovom prilikom želim da apelujem na bošnjački narod, da ništa bez njihove dozvole neće se raditi u interesu naših građana. Zahvaljujem se predsedavajući!

KRYESUESI: Faleminderit! Edhe unë besoj që shumica janë dhënë në kundërshtim me Ligjin dhe vërtet duhet hetim për këtë çështje. Nuk mund të jepen koncesione të tilla pa diskutim publik. Në asnjë vend të botës nuk ndodh kjo, veç te ne bëhen me vendime arbitrare.

Fjalën e ka zonja Izmaqu.

XHEVAHIRE IZMAKU: Faleminderit, kryesues!

I nderuar kryeministër,

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Temën që do ta trajtoj sot ka të bëjë me mungesën e ujit të pijshëm në Komunën e Vushtrrisë, që është problem kryesor i mbi 70 mijë banorëve të saj sot dhe 17 vjet pas mbas mbarimit të luftës.

Një fabrikë e ujit në Komunën e Vushtrrisë ka qenë një kërkesë e mijëra banorëve të asaj ane, kështu që më në fund ndërtimi i saj ka përfunduar. Fabrika është ndërtuar në fshatin Balincë dhe ka mundur të fillojë punën qysh në ditët e para të vitit të ri. Por, kjo s’po ndodh për shkak të mungesës së 150 mijë eurove, me të cilat do të rekrutohej stafi që duhet të menaxhojë me këtë aset. Fabrika në fjalë është investim i Qeverisë së Kosovës dhe ka kushtuar mbi 8 milionë euro. Ka qenë projekt 3-vjeçar dhe mezi përfundoi pas 5 vjetëve. Mirëpo, kjo tash nuk ka rëndësi meqenëse tani është e gatshme të fillojë me furnizimin me ujë për 70 mijë banorë.

Vlen të theksohet gjithsesi, se sipas ekspertëve tanë vendorë, por edhe ndërkombëtarë, analizat e këtij uji kanë rezultuar se janë kualitative. Për funksionalizimin e kësaj fabrike është dashur që

Qeveria, përkatësisht Ministria e Financave të flokojë mjete për të vënë në funksion dhe mos të ndodhë që ende në shekullin XXI banorët e një komune të furnizohen me ujë vetëm tre orë në 24 orë në ditë. Në ditët e verës, ka lagje në këtë qytet që nga dy muaj s'kanë fare ujë, ka fshatra që s'kanë fare ujë të pijshëm, sepse në vendet ku jetojnë nuk pihet ai ujë. Për shembull, në fshatin Stanovc të Ulët, por edhe shumë fshatra të tjera, lagje të tëra nuk mund të furnizohen as nga bunarët e tyre, mirëpo duhet të bartin ujë me kovë sikurse në shekujt përpara, prej çezmave, të cilat nuk janë as afër fshatit.

Mos të themi që banorët nëpër ndërtesa të larta në qytet janë të detyruar të mbushin po ashtu kova e shishe dhe t'i ngjisin shkallëve lart, duket pak një terminologji jo shumë e mirë për ta dëgjuar, por me të vërtetë është e pakuptimtë, në shekullin XXI padrejtësisht t'u mohohet qytetarëve të kësaj komune furnizimi me ujë të rregullt.

I nderuar kryeministër,

Unë e di se ju i keni dëgjuar me vëmendje këto ankesa edhe nga kryetari i komunës në vizitën që i bëtë herën e kaluar dhe, ta dini se po të kishte mundësi çdo qytetar i Vushtrrisë personalisht do t'ua kishte bërë këtë kërkesë, sepse vërtet është bërë një gjendje e padurueshme. Ndërsa, është e mundshme që ky problem me pak vullnet mund të mos ekzistojë më. Funksionalizimi i ujësjellësit duhet të përfundojë para se të fillojë sezoni i pushimeve për mërgimtarët tanë, sepse rritet numri i banorëve deri në 20 mijë dhe rriten edhe kërkesat.

Ministri për Zhvillim Ekonomik në bashkëpunim me kompaninë e Ujësjellësit po ashtu duhet të marrë përgjegjësinë që të adresojë te ju dhe Ministria e Financave këtë problem.

Të nderuar kolegë deputetë,

I nderuar kryeministër,

Dhe ju ministra,

Po bëhet viti i gjashtë që kur kam diskutuar këtë çështje për herë të parë dhe nuk kam besuar që edhe pas 6 vjetësh do të flas për të njëjtin problem. Si përfaqësuese e atyre banorëve kërkoj sinqerisht që të merret parasysh dhe njëherë e përgjithmonë banorët e Vushtrrisë të përshëndeten me hallin e mungesës së ujit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Danush Ademi e ka fjalën.

DANUSH ADEMI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Desha ta ngre një shqetësim për në emër të 570 familjeve të cilat janë kthyer me dhunë nga vende të treta. Po shohim që në kohën e fundit është një kthim i dhunshëm, edhe pe ne e dimë arsyen pse është bërë ky kthim. Edhe më herët e kemi ngritur këtë shqetësim në Kuvendin e Republikës së Kosovës, por kemi kërkuar që së paku këto familje kur të kthehen të kenë mbështetjen nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Këto familje fare nuk marrin përkrahje nga Ministria e Kthimit, nga Zyra e Kryeministrit që është për çështje të komuniteteve, si dhe nga donatorë të cilët sot i kemi për çështje të këtyre komuniteteve.

Ne kërkojmë që tu ofrohet ndihmë këtyre familjeve, të cilat janë kthyer me dhunë nga vendet evropiane, edhe pe e kemi marrë një lajm shumë të mirë dhe të gëzueshëm për çështjen e liberalizimit të vizave, por po e shoh që për komunitetin tim ashkali, që unë e përfaqësoj, është

pakë jo shumë e gëzueshme, sepse njeri duhet të gëzohet në qoftë se së paku e ka një shtëpi dhe ka kulmin mbi kokë dhe kushtet e mira dhe unë kërkoj nga Qeveria e Republikës së Kosovës që së paku të na lejojë që të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës t'i gëzohen këtij liberalizimi të vizave sepse ky komunitet është anashkaluar në shumë sfera.

Prandaj, unë kërkoj nga kryeministri që së paku të bisedojë me kryetarët e komunave dhe mungesa e infrastrukturës nuk rregullohet nëpër këto komuna. Ne e kemi pasur edhe më herët shumë probleme sa i përket infrastrukturës dhe edhe pse premtimet i kemi marrë edhe nga kryeministri i Republikës së Kosovës Isa Mustafa se do të kujdesen dhe më shumë do të kujdesen për banorët ku jetojnë komunitetet, por ne nuk po shohim se është bërë diçka për këto komunitete, sidomos për komunitetin ashkali, egjiptian, por edhe atë rom.

Kërkesa jonë është që së paku t'u kushtohet rëndësi këtyre tri komuniteteve sepse ne vitin e kaluar e kemi ndarë edhe kodin, një kod të veçantë për këto komunitete dhe ne jemi duke parë se asnjëherë nuk fillon për t'u zbatuar ky kod i cili është ndarë për komunitetet dhe ne kërkojmë edhe nga ministri i cili është përgjegjës për financa që së paku të kujdeset për atë kod të cilin e kemi nxjerrë po në këtë Kuvend sepse Ministria e Kthimit dhe Zyra për Çështje të Komuniteteve nuk është e njoftuar për këtë kod dhe nuk kanë ende programe si të zbatohet ky kod, prandaj kërkoj që së paku ato vendime të cilat i marrim në këtë Kuvend, së paku ministrinë përkatëse, t'i zbatojnë.

KRYESUESI: Faleminderit! I fundit është zoti Pajaziti.

ZENUN PAJAZITI: Faleminderit, zoti nënkryetar i Kuvendit!

Kolegë deputetë,

Anëtarë të Qeverisë,

Po e shtroj apo po e përcjell një shqetësim të një grupi qytetarësh për një çështje që është shtruar disa herë në Kuvend dhe fatkeqësisht ende nuk është zgjidhur. Është fjala për punëtorët tanë që kanë punuar jashtë në shtetin e Zvicrës të cilët dëshirojnë që benefitet e tyre - pensionet e tyre t'i gëzojnë nga këtu.

Unë kam biseduar edhe me ministrin Abrashi dhe është mirë që Qeveria apo Ministria e Punës është kah punon në këtë drejtim, por e shtrova këtu edhe për shkak të kërkesës së tyre dhe për shkak të një mesazhi që duhet të dalë nga ky Kuvend jo vetëm për Qeverinë por edhe për shtetin e Zvicrës. Mendoj se ambasada këtu duhet t'i përcjellë.

Është krejtësisht e padrejtë që veç Kosova ose veç ky komunitet që ka kontribuar shumë për shtetin zviceran të privohet nga të drejtat e tyre elementare që ata t'i shfrytëzojnë benefitet në pleqërinë e tyre në vendlindjen e tyre.

Mendoj se në këtë kohë ka edhe një numër tash agjencish dhe biznesesh që ndërhyjnë dhe përfitojnë në kurriz të këtyre njerëzve në vend që vite më parë kjo të ishte kryer dhe edhe pa kërkuar Qeveria e Kosovës vetë shteti i Zvicrës do të duhej të kujdesej për këta qytetarë.

Unë kërkoj nga Qeveria, zoti Abrashi që të bëjnë gjithçka që është e mundur që sa më shpejt që të jetë e mundur, sepse ky numër secilën herë është më i vogël, t'u mundësojë këtyre njerëzve

dhe të sigurojë Qeverinë e Zvicrës nga ato kritere që kanë kërkuar në mënyrë që sa më shpejt të jetë e mundur që këta qytetarë të mund vetëm me një kartelë të tyre personale të gëzojnë pensionet - benefitet e tyre dhe gjithçka për çka ata kanë punuar tërë jetën e tyre. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Konsideroj se janë kryer diskutimet nga pika e parë e rendit të ditës - deklarimet jashtë rendit të ditës.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Koha për pyetje parlamentare

Në bazë të nenit 45, paragrafi 1 të Rregullores së Kuvendit, koha për pyetje parlamentare zgjat 60 minuta.

Për këtë seancë janë 10 pyetje parlamentare.

Është një pyetje nga Njomza Emini, dhe mesa po shoh nuk është këtu.

Zoti Bekim Haxhiu ka pyetje për zëvendëskryeministrin Kujtim Shala. Zoti Haxhiu, zëvendëskryeministri Shala nuk është këtu!

BEKIM HAXHIU: Faleminderit i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Pyetja është bërë një kohë shumë më të gjatë, kështu që meqë ministri s'qenka këtu, le të përcillet në buletin zyrtar të Kuvendit. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Abdyl Ymeri, pyetje për zëvendëskryeministrin Kujtim Shala. Zoti Ymeri, e keni fjalën!

ABDYL YMERI: Faleminderit nënkryetar!

Të nderuar ministra,

Të nderuar kolegë deputetë,

Që ta kemi një shoqëri të formuar dhe të ngritur denjësisht patjetër se duhet të kemi një rini të shëndoshë. Rinia jonë sot ka më shumë nevojë për sport e kulturë se sa ta tretë kohën e çmuar nëpër kafeteri. Prandaj, institucionet tona kanë për obligim që t'u krijojnë kushte dhe hapësira për zhvillim normal të aktiviteteve sportive e kulturore, pasi që sporti na mundëson të kemi një trup të shëndetshëm ndërsa kultura na mundëson që shpirti ynë të jetë i mbushur me lumturi e dashuri.

Në disa komuna ka ca vite që ka filluar ndërtimi i palestrave sportive me qëllim të krijimit të hapësirave të mjaftueshme për zhvillim normal të aktiviteteve sportive. Në komunën e Skenderajt, një projekt i tillë ka filluar që nga viti 2009, por ende nuk ka përfunduar.

Edhe këtë vit është ndarë një shumë e mjeteve për të vazhduar këtë projekt, mirëpo nuk mjaftojnë për përfundimin e kësaj palestere.

Pyetja ime ishte: Zoti ministër, kur pritet që ky projekt të përfundojë në mënyrë që klubet sportive të kësaj komune t'i zhvillojnë ushtrimet dhe garat në ambientet e kësaj palestre?

Dhe, meqenëse ministri nuk është këtu, desha t'ia përkujtoj se që nga vërja e gurthemelimit të kësaj palestre janë ndërruar 4 ministra. Do të dëshiroj që ky ministër ta përfundojë këtë projekt sa më shpejt, para mandatit të tij. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zonja Alma Lama, pyetje për ministrin Skender Hyseni!

(Ndërrhyrje)

Urdhëro! Tjetër ditë! E nëse do ta lexosh, mundesh. E tjetër ditë, bërja tjetrën pyetje, por unë dua të them se ministrat kanë obligim kushtetues e ligjor me iu përgjigjur deputetëve dhe ministrat kanë obligim kushtetues e ligjor t'u përgjigjen ftesave të komisioneve parlamentare.

Mendoj se e kanë gabim që nuk vijnë për t'u përgjigjur deputetëve dhe e kanë gabim që nuk iu përgjigjen komisioneve parlamentare për të marrë pjesë në mbledhje. Zonja Lama, e keni fjalën!

ALMA LAMA: Faleminderit!

Pavarësisht që ministri nuk është, unë do ta bëj pyetjen. Rreth një vit më parë, Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të Kosovës. Ky ligj, me rëndësi strategjike që synon të parandalojë të rinjtë e Kosovës në marrjen pjesë në luftëra të huaja apo të bashkohen me organizata terroriste, si dhe ndëshkon ata që kthehen, u miratua me vonesë mirëpo ka filluar të implementohet dhe një vit është kohë e mjaftueshme për të marrë edhe rezultatet e para, për të parë se si është zbatuar, prandaj pyetja ime për ministrin e Brendshëm është kjo:

A ka ndikuar ky ligj në zvogëlimin e numrit të të rinjve nga Kosova që i janë bashkuar luftës në Siri apo në atë rajon, apo janë bërë anëtarë të ISIS-it? Nëse po, cilat janë shifrat? Nëse jo, po ashtu, na duhet përgjigja. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Slavko Simiq, pyetje për deputetin Arban Abrashi.

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predjedavajuć!

Poštovani ministri,

Dame i gospodo narodni poslanici,

Želim da predstavim jedan veoma ozbiljan problem koji je na samom početku ove sednice predstavio i gospodin Nenad Rašić. Dakle, problem sa kojim se suočavaju naši građani a problem preko koga su najviše degradirani na neki način naši građani.

Naime, osnovna penzija je jedan od oblika obaveznih penzija i daje se svakom građanu Kosova koji je stariji od 65 godina i koji je stalni stanovnik Kosova bez nekog drugog uslova.

Osnovna penzija kao i socijalna pomoć daje se iz opšteg budžeta Kosova. Uslov koji je zakonom regulisan, koji je do sada važio, bila je važeća lična karta koja je izdata od Ministarstva

unutrašnjih poslova Kosova. Uz redovno javljanje u centre za socijalni rad apsolutno nikakvih drugih uslova nije postojalo do sad.

Međutim, odnedavno, bez obzira da li je neko građanin Kosova i redovno se javlja u lokalne centre za socijalni rad, građanima su penzije suspendovane ili ukinute. Objašnjenje za suspenziju penzija je da nisu podneli dokaze da žive na Kosovu odnosno da računi za lokalne ređije kao što su voda, struja, telefon i slično, nisu oglasili na njihovo ime.

U vezi ovog problema, imam pitanje za ministra za rad isocijalnu zaštitu, gospodina Arbana Abrašija.

Gospodine ministre, s obzirom da pravo na osnovnu penziju naši građani ne mogu da ostvare zbog novih pravila koja nisu zakonom regulisana, ja vas pitam - na osnovu kog zakona se primenjuje dokazano uslovljavanje da bi se ostvarilo pravo na penziju? Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër Abrashi, e keni fjalën!

MINISTRI ARBAN ABRASHI: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Kabinet,

Deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Sa i përket pyetjes, ashtu si e parasheh ligji, përfituesit e pensionit bazë janë të gjithë qytetarët e Kosovës që i plotësojnë këto kushte:

Duhet të jetë mbi moshën 65 vjeçare, duhet të jetë banor i përhershëm apo shtetas i Republikës së Kosovës, duhet të ketë ekstraktin e lindjes nga Agjencia e Regjistrimit Civil të Republikës së Kosovës dhe duhet të konfirmojë banimin e përhershëm në territorin e Republikës së Kosovës me dëshmi tjera të cilat janë të listuara, si shërbimet publike, telefoni, uji, rryma, mbeturina, fleta poseduese ose ndonjëra nga këto.

Të gjitha këto kriteret janë të bazuara në Ligjin për skemat pensionale të financuara nga shteti dhe udhëzimet administrative 10/2013, 9/2015... që përcaktojnë këto rregulla dhe procedura.

Ajo çka ndodh ditëve të fundit është se,realisht për shkak të presionit ndaj këtyre skemave, nevojës që të rishikohen skemat në tërësi, që të kontrollohen, të jetë i targetimi më i mirë, të menaxhohen më mirë në aspektin financiar dhe disa nga këto rregullore kanë filluar të zbatohen edhe pse ligji i parasheh ato. Dhe njëri prej kriterëve kryesorë ka qenë shtetësia apo rezidenca, dhe kjo ka filluar të zbatohet duke kërkuar nga zyrtarët pensionale dokumente shtesë qoftë fatura të ujit, të rrymës apo fletë poseduese.

Ndodhë që disa nga pensionistët nuk i kanë këto në emrin e tyre dhe kjo rregullohet me një ekstrakt të familjes të cilën e merr në zyrtarët komunale apo në regjistrin civil dhe mund të vërtetohet se jeton brenda asaj familje.

Për mos ta bërë këtë politike, apo me dalë jashtë fjalimeve interesante, ideja themelore është që të kontrollohen më mirë këto skema dhe mos të përfitojnë pensione, në këtë rast pension bazë,

ideja themelore e këtij pensioni është asistencë apo pension i pleqërisë, apo lloj asistence e pleqërisë. Edhe targetimi themelor kur është bërë, edhe si skemë, që është skemë e mirë dhe po e përmendi është skemë e mirë dhe nuk e kanë shumë vende në botë. Realisht, e ka vetëm Norvegjia në Evropë, si skemë është e mirë por ne duhet ta kontrollojmë sepse ka dalë jashtë kontrollimi në të cilin përfitojnë qytetarët e Kosovës, të cilët nuk jetojnë këtu. Kanë marrë letërnjoftim apo pasaportë të Kosovës në mënyrë të ndryshme gjatë këtyre viteve por ajo çka ndodhë nuk jetojnë në Kosovë dhe ditën kur merret pensioni krijohen rende të gjata të veturave në pikat kufitare.

Ky është një presion ose rekomandim që kemi marrë nga institucionet financiare, është edhe presion i marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat po tentojmë t'i arrijmë sikurse me Zvicrën të cilën veç e kemi arritur në presion dhe kemi arritur një para marrëveshje. Domethënë janë parakushte dhe janë praktika ndërkombëtare e nuk po zbulojmë asgjë të re, nuk është targetuar ndaj asnjë qytetari dhe ideja themelore e kësaj është që qytetarët e Kosovës që janë mbi 65 vjeç në moshë nuk kanë kontribuar, nuk kanë të hyra, por jetojnë në Kosovë, janë rezidentë kur donë të përfitojnë nga kjo skemë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë? Zoti Simiq ka pyetje shtesë!

SLAVKO SIMIĆ: Hvala predsedavajući!

Gospodine ministre, te šeme koje vi spominjete one se sprovode na osnovu administrativnog uputstva koje je donelo Ministarstvo za rad i socijalnu zaštitu i to administrativno uputstvo koliko sam ja proučio, to administrativno uputstvo nije u opšte po zakonu. Dakle, to administrativno uputstvo treba da se povuče i da se svaka dopuna ili svako pojašnjenje zakona ovde usvoji u Skupštini. Zato vas pozivam da povučete to administrativno uputstvo kako naši građani ne bi imali problema.

Ovde ja ne govorim samo o Srpskoj zajednici, odnosno ne govorim u ime Srpske zajednice, nego govorim u ime svih zajednica koje žive na Kosovu. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Raif Qela, pyetje për ministrin Dalibor Jevtiq.

RAIF QELA: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Zoti kryeministër,

Kabinet qeveritar,

E kam pyetje për zotin ministër, është kjo: Nëse Ministria për Komunitete dhe Kthim e ka për detyrë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe të pjesëtarëve të tyre, duke përfshirë edhe të drejtën për t'u kthyer në përputhje me Kushtetutën e Kosovës, nëse kjo ministri promovon krijimin e kushteve të përshtatshme për kthim dhe siguron një qasje ndaj kthimit që bazohet në të drejtat, sa ka kontribuar kjo ministri në kthimin e qytetarëve shqiptarë të Kosovës të dëbuar nga pronat e veta në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës, e cila tani i përket Komunës së Mitrovicës Veriore? Sa shtëpi për këta qytetarë janë ndërtuar nga fondet e kësaj ministrie me qëllim të kthimit të tyre në pronat e veta? Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti ministër Jevtiq, e keni fjalën.

MINISTRI DALIBOR JEVTIĆ: Poštovani predsedavajući,
Poštovane poslanice i poslanici,
Članovi Vladinog kabineta,
Dam i gospodo,
Poštovani gospodin Qela,

Najpre da se zahvalim na interesovanju o pitanju povratka raseljenih na Kosovo. To je jako važno pitanje, pitanje koja je od suštinske važnosti za sve buduće procese, ako hoćete i evropske integracija, pa ću da vas na najbolji mogući način izvestim oko onoga što vas interesuje, i oko pitanje koje ste postavili.

Najpre da vas upoznam da je Ministarstvo za zajednice i povratak formirano 2005. godine, i mi smo od tada do danas na severu Kosova, a govoriću sada pošto je vaš predmet interesovanja Albanska zajednica, izgradili ukupno 31 kuću za pripadnike Albanskog naroda koji su se vratili u taj deo Kosova.

Konkretno što se tiče problema koji ste spomenuli je problem povratka raseljenih u severni deo Mitrovica. Mi smo zajedno sa našim međunarodnim partnerima, pred svega Britanskom ambasadam i Danskom savetu za izbeglice pokrenuli projekat "Održivi povratak u grad Prizren i severna Mitrovica", koji su upravo odnosi na povratak pripadnika Albanskoga naroda u severnom deo grada, i projekat BRIK, koji je deo projekta USAID-a, i u okviru ovih projekata mi smo završili do sada popravke na stanovima za 10 povratnički porodica u grad severna Mitrovica, pri čemu su ove porodice već dakle vraćene u ovaj deo grada i sada se već nalaze u svojim stanovima, koji su popravljani i obnovljeni i vraćeni u njima.

U jedno su u toku tri projekta za zajednicu u severnoj Mitrovici, i kao što rekao ovaj projekat se sprovodi zajedno sa našim partnerima Britanskim ambasadam i Danskom savetom za izbeglice.

Što se tiče projekata BRIK, dakle to podrazumeva renoviranje objekata, finansiranje od strane Američke ambasade, sprovodi ga međunarodna organizacija za migracije i Komisija sastavljena od predstavnike opštine Severna Mitrovica UNCHR, IOM, Ministarstvo za zajednice i povratak, i mi smo do sada posetili više porodica koje ćemo asistirati, tri porodice su već identifikovane kao najugroženije i one će biti prioritet u narednom periodu.

Želim da naglasim da je Ministarstvo za zajednicu i povratak u potpunosti posvećenu u povratku svih raseljenih lica u svoje domove, i pri tom ne praveći razliku između pripadnosti, bilo da su oni Albanci...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Vazhdoja ministrit edhe pak!

MINISTRI DALIBOR JEVTIĆ: ...dakle bilo da su oni pripadnici bilo kog naroda pravo na povratak i njihovo neotuđivu pravu i osnovno ljudsku pravo na kraju krajeva, i u skladu sa tim Ministarstvo za zajednici i povratak kao što ste i vi sami u pitanju naveli jeste tu da promovise to pravo, ali što se povratka raseljenih tiče ne zavisi sve od Ministarstva za zajednici i povratak,

zato uključujemo sve relevantne faktore kako bi taj proces - proces povratka - na kraju krajeva bio je održiv.

U skladu sa tim formirana je međuministarstva Komisija za povratak u kojoj su učešće uzeli predstavnici drugih vladinih institucija, formirane su dve podgrupe koje se bave pitanje povratka raseljenih u naselje Brđani u opštini Severna Mitrovica, i u selu Mušitište opštine Suva Reka.

Dakle mi želimo da na jedan kvalitetan način ovo pitanje rešavamo uz isključivanje svih relevantnih faktora kao što sam već rekao, i da se ovaj broj, a ukupan broj s kojim mi raspolazemo raseljenih, dakle opet ne govorim samo o pripadnicima jednog naroda, je preko 200 hiljada. Dakle svi onih su predmet naših interesovanja, i zato je potrebno da svaka institucija da svoj doprinos u skladu sa svojim oblastima delovanja kako bi taj povratak bio u što kraćim periodu, sa jedne strane, i sa druge strane da on bude održiv.

Na kraju, dozvolite mi da kažem kada već spominjem Brđane, mi smo uspeli i odobrili povratak 3 porodice koje tamo treba da se vrata, dakle da obnovimo kuće, i to je prvi korak. Za Mušitište još uvek nismo na taj prvi korak, koji očekujem da se on desi, a imamo punu podršku lokalne samouprave.

I ja vas pozivam, kao i svakog koje je zainteresovan da prati rad ovih komisija i ovih tela, kao i rad Ministarstvo za zajednice i povratak, da to i učini, i mi smo to na raspolaganju, Ministarstvo za zajednicu i povratak je u potpunosti transparentno i sve informacije će uvek biti dostupne svakom onom ko se interesuje za ovo pitanje. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shitesë, zoti Qela?

RAIF QELA: Zoti ministër!

Ju falënderoj për përgjigjen. Me sa e kuptova, u zotuat që do ta vazhdoni punën në mënyrë që të gjithë qytetarët e dëbuar nga pronat e veta të kthehen në pronat e veta. Janë edhe rreth 400 banesa të uzurpuara në pjesën veriore të qytetit të Mitrovicës, banesa të cilat janë të pronarëve shqiptarë. Kanë qenë shumë më shumë por një pjesë e tyre janë shitur, w janë rreth 400 shtëpi të pandërtuara. Sa do që buxheti i kësaj ministrie është i vogël, me çfarë intensiteti do të vazhdoni, në mënyrë që të vazhdojë ndërtimi i shtëpive të qytetarëve shqiptarë në pjesën veriore të dëbuar nga ajo pjesë, si dhe çka do të ndërmerrni, në mënyrë që qytetarët e dëbuar nga banesat e veta në pjesën veriore të kthehen në pronat e uzurpuara padrejtësisht? Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI DALIBOR JEVTIĆ: Dakle, upravo zbog činjenice da Ministarstvo za zajednice i povratak ne može samofinansijski da isplati sve potrebe u procesu povratka, mi ostvarujemo saradnju sa onim organizacijama, pre svega međunarodnim, koje mogu da nam pomognu u tom procesu.

Ovih dana, danas i sutra se u Prištini inače održava konferencija na regionalnom nivou koja uključuje pored predstavnike Vlade Kosova, Vlade Crne Gore, Makedonije i Srbije, uz podršku

OEBS-a i UNCHR, kao i Kancelarije Evropske Unije na Kosovu. Dakle mi radimo upravo na rešavanje ovog pitanja.

Problem uzurpiranim imovine je problem koji smo mi identifikovali kao jedan od važnih problema koji mora da se reši u procesu povratka raseljenih.

Problem uzurpiranje imovine po nama mora da se rešava na taj način da postoji, ja sam o ovome razgovarao sa ministrom pravde i sa ostalim relevantnim institucijama, dakle je naš predlog da postoji poseban panel koji će se baviti samo pitanje uzurpiranim imovine, jer je veliki broj onih slučajeva koji se još uvek nalaze recimo u sudovima, koji još uvek nisu rešili pitanje uzurpiranim imovine, i opet ponavljam. Govorim o kontekstu svih, ne samo pripadnika jednog naroda, nego svih onih koji imaju ovaj problem. Tako da mi mislimo da upravo jedan takav poseban panel može da pomogne u ubrzavanju procedure rešavanja ovog pitanja, kako bi smo mi povratak raseljenih rešili u što kraćem roku.

Ja ću vam dati jedan podatak, dakle mi imamo 1 167 lica pripadnika Albanskog naroda koji su nam se javili, koji traže dakle povratak u svoje domove, i u skladu sa tim smo pokrenuli zajedno sa Danskim savetom za izbeglice - UNCHR-om, pokrićemo dakle i pripadnike Srpskog naroda, pripadnike Romskog naroda, Aškaljiskog naroda, Egipćanskog naroda, dakle radićemo u narednom periodu, u narednih tri meseca u profilizaciju tih ljudi, kako bi smo na taj način jasno ustanovili potrebe i finansijske i svake druge, kako bi smo omogućili njihov povratak na svojoj imovinu. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Zoti Raif Qela, pyetje për kryeministrin Isa Mustafa. Zoti Mustafa e ka pasur një takim urgjent dhe e ka ngarkuar ministrin Demolli që të përgjigjet në pyetjen tuaj, varësisht prej jush. Zoti Qela e ka fjalën.

RAIF QELA: E shtyj për mbledhjen e radhës.

KRYESUESI: Në rregull. Deputetja Mexhide Mjaku-Topalli, pyetje për ministrin Abdullah Hoti.

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: I nderuar kryesues, ministra, deputete, deputetë, Çështja që do ta paraqes sot ka të bëjë me teatrot në qytetet e Republikës së Kosovës.

I nderuar ministër,

Për shkak të mosharmonizimit të ligjeve, teatrot e qyteteve të Republikës sonë kanë mbetur nën mëshirën e ndihmave të Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport dhe nuk janë institucione të pavarura të teatrit.

Dihet se me Ligjin për teatrot komunat duhet ta zbatojnë këtë ligj, mirëpo komunat nuk po mund ta zbatojnë ligjin me arsyetimin se nuk kanë kod buxhetor të cilin nuk po e ndan Ministria e Financave.

I nderuar ministër, pyetja është: Pse nuk është ndarë ky kod buxhetor dhe kur do t'u ndahet teatrove ky kod buxhetor, pasi që Ligji për teatrot, neni 19, pika 2 thotë: "Mjetet financiare për

punën e teatrove publike sigurohen nga buxheti i Qeverisë së Republikës së Kosovës”.
Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti ministër, e keni fjalën.

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues i seancës!

E nderuar deputete,

Me Ligjin numër 04/L-106 për teatrot, statutin e teatrit të qytetit e harton Këshilli Drejtues i teatrit dhe aprovohet nga Kuvendi i Komunës, pas propozimit të këtij statuti nga kryetari i Komunës për Kuvend.

Mjetet financiare për teatrot ndahen nga komunat përkatëse brenda kufijve buxhetorë që kanë komunat.

Pra, është çështje krejt teknike e komunave. Në atë moment që komunat në kuadër të grantit prej 10% që marrin nga buxheti qendror ndajnë mjete për teatrot e qyteteve, çështja e kodeve është çështje komplet teknike që rregullohet në proces të përgatitjes së buxhetit. Pra, është vetëm çështje teknike, në shumicën e rasteve është mungesë e buxhetit të mjaftueshëm nga komunat për të ndarë edhe për teatrot. Është planifikim komplet i komunës. Nëse komuna ndan veçmas buxhet për teatrot, është çështje teknike caktimi i atyre kodeve. Tash ne jemi në proces të përgatitjes së buxhetit për vitin 2017, shpejt do t’i lëshojmë instruksionet e para, e nëse na vijnë propozimet prej komunave për buxhet të veçantë për teatro, ne e akomodojmë brenda Thesarit pa asnjë problem. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Pyetje shtesë, zonja Mjaku?

MEXHIDE MJAKU-TOPALLI: Faleminderit për përgjigjen!

Zoti ministër, unë e kam një kërkesë që i është parashtruar drejtorit të Departamentit të Thesarit nga kryetari i Komunës, me të cilën ka kërkuar që t’u mundësohet, apo të krijohet një kod buxhetor për Teatrin e Qytetit “Adriana Abdullahu” në Ferizaj.

Arsyetimi është i drejtë, meqë thotë: “Teatri i Qytetit “Adriana Abdullahu” i plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret, si në aspektin e infrastrukturës përkatëse, të bazuar në normat ndërkombëtare, e po ashtu edhe të kuadrit përkatës, reporterit të publikut, çështjet organizative, shtrirjes rajonale, duke përfshirë komunat Kaçanik, Hanin e Elezit, Shtërpcën, Shtimen e kështu, dhe kanë mbetur me shpresë se do t’u ju përgjigjeni rreth krijimit të kodit buxhetor për teatrin e qytetit të Ferizajt. Faleminderit!

KRYESUESI: E keni fjalën zoti Hoti.

ABDULLAH HOTI: Pra, nëse më lejon të sqaroj: 10% e të hyrave qendrore i marrin komunat dhe është diskrecion i plotë i komunave sesi e planifikojnë atë të hyrë. Në atë moment që një komunë e caktuar planifikon mjete për një teatër, ne e krijojmë kodin për atë teatër në proces të rregullt buxhetor, jo në mes të vitit, kur veç janë parashikuar shpenzimet dhe kodet përkatëse për ato shpenzime.

Nëse ka kërkesa tash, domethënë deri më 30 shtator, kur komunat i sjellin në Ministrinë e Financave buxhetet e tyre me kodet përkatëse, ne i akomodojmë sipas kërkesave të tyre, sepse është autonomi e tyre që t'i shpërndajnë ashtu si e shohin të arsyeshme.

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hoti! Zonja Deliu-Kodra, pyetje për ministrin Imet Rrahmani. Ministri nuk qenka këtu, e lini për seancën e ardhshme. Pyetja e fundit, e dhjetë, është zonja Deliu, pyetje për ministrin Arban Abrashi. Zonja Deliu, e keni fjalën.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, kryesues!

I nderuar Kabinet qeveritar,

Kolege dhe kolegë deputetë,

Pyetje ime sot lidhet me ndryshimet në Ligjin e ri të punës, konkretisht me nenin 49 për pushimin e lehonisë, është pjesa e agjendës legjislative për këtë vit plotësim-ndryshimi i këtij ligji.

Ministria e Punës e ka hartuar një projektligj për ndryshimin e këtij ligji, por nuk e di nëse drafti është finalizuar ende.

Po ashtu, në këtë draft ndryshimet më të mëdha pritet që të jenë në nenin 49, një nen i cili vazhdimisht ka pasur përplasje ndërmjet Qeverisë, sindikatave, si dhe bizneseve. Prandaj, e kërkoja një sqarim prej ministrit cilat do të jenë ndryshimet dhe në cilat pika konkretisht pritet plotësim-ndryshimi i Ligjit të punës.

KRYESUESI: Ministri Abrashi e ka fjalën.

ARBAN ABRASHI: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar ministra, deputetë,

E nderuar deputete Blerta,

Qeveria e Kosovës në bazë të programit legjislativ të vitit 2016 ka paraparë edhe ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të punës 03/L-212. Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale si bartëse e këtij projektligji, ndër të tjera, ka propozuar edhe rishikimin e dispozitave që e trajtojnë pushimin e lehonisë.

Pushimi i lehonisë është si njëra prej sfidave më të vështira me të cilën është ballafaquar gruaja dhe femra në mbrojtjen e vendit të punës pas përfundimit ose gjatë pushimit të lehonisë.

Kjo çështje sot konsiderohet si një sfidë, jo vetëm për Kosovën, por edhe për shumë vende të tjera të zhvilluara.

Gjatë mandatit si ministër i Punës dhe Mirëqenies sociale kemi hasur në shumë të gjetura, të cilat kanë ndikuar negativisht në punësimin e grave, për shembull ndërprerja e punës apo mosvazhdimi i kontratës së punës pas skadimit të afatit nga punëdhënësit si pasojë e shtatzënisë apo lindjes së fëmijës.

Shfrytëzimi i ulët i pushimit të lehonisë që paguhet nga Qeveria e Republikës së Kosovës, shkalla e ulët e përqindjes totale të grave të punësuara, sidomos në sektorin privat, si dhe njohuritë e të drejtave të tyre të punës, në përgjithësi.

Shfrytëzimi i pushimit të lehonisë sipas statistikave ka treguar se lehonat, pra gratë e punësuara e kanë shfrytëzuar shumë pak tremujorin, i cili paguhet nga Qeveria.

Nëse i shohim këto statistika, shihet se vetëm një pjesë e vogël e grave ka rezultuar si shfrytëzuese e kësaj të drejte. Kjo tregon se synimet e politikës sociale të deritanishme nuk kanë qenë aq të mira, pra nuk kanë pasur target shumë të mirë, duke e ditur se punëdhënësit në Kosovë janë barra kryesore e pagesës së pushimit të lehonisë pikërisht duke qenë edhe kërkesa kryesore e komunitetit të bizneseve, të cilët kanë kërkuar që të trajtohet mënyra e pagesës.

Lidhur me këtë ne kemi ndërmarrë hapa dhe duke marrë parasysh që punëdhënësit kryesorë në Kosovë janë ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, të cilat e kanë të vështirë t'i përballojnë pagesat e pushimit të lehonisë në kushtet aktuale, ne kemi filluar ta trajtojmë edhe këtë çështje.

Sa për informatë, Ligji i punës është ende në diskutim publik. Jemi duke marrë idetë nga Këshilli Ekonomik-Social, nga punëdhënësi, nga sindikatat, nga të gjitha palët e interesuara, nga deputetët, nga një numër i madh i analistëve, apo gjithë ata që involvohen rreth këtyre punëve dhe ende jemi duke i trajtuar idetë kryesore rreth kësaj.

Nuk ka ndonjë vendim të prerë. Ideja kryesore e cila mbizotëron në Këshillin Ekonomik-Social, ku janë të përfaqësuar punëdhënësit, odat ekonomike, Aleanca e Biznesit dhe sindikatat është që të ndryshohet shuma apo kohëzgjatja e pagesës, si njëra prej ideve kryesore e cila po diskutohet tash, në mënyrë që barra e pagesës së bizneseve të zvogëlohet nga 6 muaj në 4,5 muaj dhe këtë barrë ekstra 1,5 muaj ta marrë Qeveria.

Domethënë nuk është diskutuar aq shumë kohëzgjatja, e cila me siguri do të mbetet 12, por barra e pagesës të bizneset, pasi është parë si njëra prej arsyeve kryesore, që gratë apo femrat kanë shkallë të ulët të punësimit në sektorin privat.

Ekziston një vullnet i mirë nga ministria dhe Qeveria që ta marrin një pjesë të barrës financiare që t'i lehtësojmë bizneset që të punësojnë sa më shumë gra, në mënyrë që të ketë ndikim pozitiv edhe te lehonat, të ketë ndikim në politika më të mira sociale dhe në punësimin e femrave.

Por çka mund të them për momentin, e që është ende në diskutime publike dhe ka kohë edhe disa muaj, pasi me të vërtetë dëshirojmë ta shterim këtë debat, pasi është një prej temave më të ndjeshme sa i përket Ligjit të punës.

Përpos kësaj teme, që i përket lehonisë apo barrës financiare, e cila do t'u zvogëlohet tentativisht bizneseve, ne propozojmë edhe skema tjera në kuadër të kësaj, sikur pushimi apo beneficione shtesë për nënat të cilat lindin binjakë apo trinjakë, apo më shumë fëmijë.

Domethënë, ka edhe çështje tjera administrative që ndërlidhen me kohëzgjatjen e kontratave, me skadimin e kontratave, e kështu me radhë.

Ajo çka dua të them për këtë moment është që gjithçka po bëhet në diskutim ditore me odat ekonomike, me sindikatat dhe gjithë njerëzit tjerë, me rrjetin e grave të Kosovës dhe gjithë të angazhuarit rreth kësaj dhe nuk do të marrim vendim jashtë debatit, apo vendim unanim krye më vete pa u diskutuar të gjithë me të gjithë.

Duhet edhe disa muaj që të shteret ky debat, por besoj që deri në vjeshtë do të dalim me një propozim konkret. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.)

KRYETARI: Zonja Deliu-Kodra, keni pyetje shtesë? Urdhëro!

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, ministër!

Mendoj që ndryshimet janë të mirëpritura, posaçërisht për nënat që do të lindin binjakë dhe trinjakë, për beneficionet që shteti do t'u japë këtyre grave.

Mirëpo, janë statistikat ato që flasin që në vitin 2015 vetëm 1 400 gra e kanë shfrytëzuar pushimin e lehonisë, prej 24 mijë lindjeve sa ka ndodhur gjithsej, dhe prej tyre janë vetëm 3 500 gra të punësuar. Mendoj që këto shifra duhet të jenë alarm për institucionet tona, që ne të jemi shumë të kujdesshëm që këtyre grave t'u krijojmë kushte që ta kenë një pushim të lehonisë dhe që të ketë rritje edhe hapje të vendeve të reja të punës, sepse statistikat flasin që shumë pak e kanë gëzuar këtë pushim të lehonisë për shkak të shifrës së vogël të grave që e kanë një vend pune.

KRYETARI: Faleminderit! E dëshiron fjalën? Jo. Atëherë vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i procesverbaleve nga seancat e mëparshme

Të nderuar deputetë, në qoftë se keni vërejtje në procesverbalet e seancave plenare, të mbajtura më 24 mars, në orën 10:00; më 24 mars, në orën 17:30, dhe 30 mars 2016, urdhëroni! Në qoftë se nuk keni vërejtje, atëherë konstatoj se Kuvendi i miratoi procesverbalet e seancave të mbajtura më 24 mars, në orën 10:00 dhe më 24 mars, në orën 17:30, dhe më 30 mars 2016.

Në sallë janë 65 deputetë. Urdhëro, kryetari i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Beqiri!

ISMET BEQIRI: Faleminderit, kryetar!

Në konsultim edhe me kolegët, propozojmë që për shkak të nevojës për disa konsultime, sot të hiqet pika 13 dhe të shtyhet për mbledhjen tjetër. Faleminderit!

KRYETARI: A ka mundësi për një votim formal? Pika e 13-të, e kemi një propozim, vetëm me ngritje dore. Kush është për që ta largojmë nga rendi i ditës? Kundër, a ka? Një është kundër. Abstenim? Dy abstenime.

Kanë votuar 65 deputetë, aprovohet kërkesa e zotit Beqiri. Kalojmë në pikat tjera të rendit të ditës:

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit

Deputetë të nderuar,

Ju njoftoj se para se të procedojmë në shqyrtimin e këtij projektligji, Kuvendi duhet të deklarohet për propozimin e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa që shqyrtimi i këtij projektligji të bëhet me procedurë të përshpejtuar.

E ftoj kryetarin e Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, zotin Naser Osmani që ta paraqesë propozimin.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Shqyrtimi dhe miratimi i Projektligjit numër 05/L-096 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit të bëhet në procedurë të përshpejtuar - shmangie nga afatet procedurale të parapara me nenin 56, paragrafi 1 dhe nenin 57 paragrafi 3, 8 dhe 9 të Rregullores së Kuvendit dhe atë si vijon:

1. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit të bëhet sot në seancën plenare, më 18 maj;
2. Shqyrtimi i Projektligjit në fjalë nga Komisioni FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa dhe komisionet e përherëshme duhet të përfundojë jo më vonë se më 23 maj 2016;
3. Shqyrtimi i dytë i projektligjit në fjalë të bëhet në seancën plenare, jo më vonë se më 25 maj 2016.

KRYETARI: Faleminderit, zoti Osmani! Tani radhën e kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare në mënyrë elektronike, në qoftë se duan të deklarohen. PDK-ja nuk ka, LDK-ja s'ka, "Vetëvendosja" s'ka, AAK s'ka, Lista serbe s'ka, "Nisma" nuk ka, "6+" nuk ka.

Në bazë të nenit 84 të Rregullores së Kuvendit na duhen 2/3 e votave të deputetëve të pranishëm që të bëjmë shmangie nga Rregullorja. Atëherë, sa deputetë i kemi në sallë? 66 deputetë janë në sallë.

Kush është për shmangie nga Rregullorja? Në mënyrë elektronike votojmë për shmangie nga Rregullorja. Votojmë tash!

56 vota për janë me kartelë, plus zonja Alma Lama, gjithsej 57 vota për shmangie nga Rregullorja, 5 janë abstenime dhe një kundër.

Të nderuar deputetë,

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

E ftoj ministrin e Financave, zotin Abdullah Hoti, që para deputetëve ta prezantojë dhe arsyetojë projektligjin.

Ju lutem, tre minuta pauzë! Urdhëro, zoti Osmani a mund ta bëjë? Atëherë, tre-pesë minuta, vetëm për një konsultim të shkurtër.

Ndërkohë e ftojmë ministrin e Financave që t'u bashkëngjitet punimeve në Kuvend. Kërkojmë falje se ministri i Financave nuk është fajtor, ta kemi parasysh, se ka menduar se pika e rendit të ditës do të jetë pak më vonë.

5. Votimi i Projektligjit për Akademinë e Drejtësisë

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se diskutimet në këtë pikë kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur më 29 prill 2016, por për mungesë të kuorumit nuk është proceduar për votim. Andaj procedojmë tani për votim.

Sa deputetë i kemi në sallë? 64 deputetë janë në sallë.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Jo, tani edhe një herë do të votojmë. Thërras Administratën që edhe një herë t'i thërrasë deputetët që të kthehen në seancë. Edhe dy deputetë i kemi pa kartelë, zotin Enver Hoxhaj dhe zonjën Alma Lama. Atëherë, Administrata thirrje edhe një herë deputetëve!

(Ndërprerje e shkurtër e incizimit)

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Zonja Lama, e ke tash kartelën? OK!

Atëherë, 58 deputetë janë për, 6 abstenime. 64 deputetë kanë votuar, plus zoti Hoxhaj është për, 65 vota, 59 deputetë janë për.

Konstatoj se e Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për Akademinë e Drejtësisë.

Ngarkohet Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren e Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për patentë-shofer

Komisioni Funkcional dhe Komisioni për Legjislacion në pajtim me vendimin e Kuvendit, datë 30 mars 2016 kanë harmonizuar qëndrimet për amendamentet e propozuara në Projektligjin për patentë-shofer dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

E ftoj deputetin Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, që para deputetëve të paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

Ndërkohë zoti Raif Qela është lajmëruar. Urdhëroni, zoti Qela, fjala për ju.

RAIF QELA: Të nderuar deputetë,
Kabinet qeveritar,

Projektligji për patentë-shoferi i sponsorizuar nga Ministria e Infrastrukturës ka ardhur në Kuvend, siç e dini, me mjaft probleme teknike gjuhësore dhe në përgjithësi nga ana profesionale nuk ka pasur vërejtje, megjithëse edhe ato nuk kanë munguar. Përkundër faktit se është dashur të punojë shumë komisioni dhe grupi punues, mendoj se ky projektligj tanimë i plotëson të gjitha kushtet që të bëhet një ligj i mirë, i cili do ta rregullojë këtë fushë.

Problemet që i kanë hasur komisioni dhe grupet punuese i ka evituar, është harmonizuar me Komisionin për Legjislacion rreth çështjeve kontestuese. Ka mbetur edhe këtu ta shtrojë se na është përvjedhur një gabim teknik në amendamentin 56, që ka të bëjë me minimumin e orëve mësimore nga ana teorike dhe praktike për aftësim të kandidatit për kategorinë B dhe kategoritë tjera. është dashur të jetë edhe pjesa si vijon: Përveç nenit 44, paragrafi 1, i cili ndryshohet siç e keni të shënuar në projektligj me amendament, është dashur t'i shtohet edhe kjo: pra, pjesë e amendamentit 56 është edhe kjo.

Neni 46, paragrafi 1 ndryshon si vijon: “Minimumi i orëve mësimore nga pjesa praktike e aftësimit të kandidatit për kategorinë B janë së paku 20 orë, ndërsa për kategoritë tjera janë së paku 15 orë”.

Komisioni konsideron se numri i orëve të parapara në projektligjin e sponsorizuar prej ministrisë është i madh dhe si i tillë nuk e arsyeton vetveten, nga shkaku se kandidatët detyrohen të paguajnë shumë më shumë se më përpara, ndërsa me nga 20 orë teorike dhe 20 orë praktike të aftësimit mjafton që ata të përgatiten në mënyrë që të bëhen shoferë të mirë. Prandaj, ky amendament është i tillë çfarë thash tani.

Është çuar mjaft pluhur edhe rreth asaj se do të ketë apo nuk do të ketë patentë-shoferi ndërkombëtare, për shkak se është bërë mjaft shumë problem në opinion, po theksoj se patentë-shoferi ndërkombëtare do të ketë, sepse duhet të ketë për arsyen e thjeshtë, sepse një pjesë e qytetarëve të Kosovës do ta kenë nevojën për të. Patenta e shoferit ndërkombëtare nuk do të jetë e nevojshme për qytetarët të cilët udhëtojnë nëpër vendet e Evropës Perëndimore edhe nëpër një serë shtetesh të tjera, por do të jetë e nevojshme për ato shtete, të cilat nuk e njohin patentë-shoferin e Kosovës dhe alfabetet e të cilave shtete nuk janë latine, shtete të cilat përdorin alfabetin sllav, arab, kinez, japonez, koreanë e të tjera dhe zyrtarët e të cilave kanë nevojë ta dinë se çfarë përmban patentë-shoferi. Si rezultat i kësaj duhet të jetë edhe një dokument plotësues, që do ta identifikojë të person dhe të ketë mundësi të komunikojë me organet përkatëse të atyre shteteve, në mënyrë që të mund ta drejtojë makinën lirshëm dhe të mund të marrë shërbime në renta car, e të tjera.

Si rezultat i kësaj jemi mbështetur në Konventën e Vjenës të trafikut rrugor të datës 8 nëntor 1968 dhe e amendamentuar më 1993.

Përkufizimi për patentë-shoferi ndërkombëtare është kështu tani. Pas harmonizimit me Komisionin për Legjislacion, duke e parë nevojën e tyre që të precizohet edhe më mirë se çka është patentë-shoferi ndërkombëtare.

Patentë-shoferi ndërkombëtare është dokument i nxjerrë sipas kërkesës së palës, i cili i mundëson mbajtësit të tij që ta drejtojë automjetin në ato shtete jashtë Kosovës, të cilat e kërkojnë këtë dokument plotësues, sipas Konventës së Vjenës për trafikun rrugor të datës 8 nëntor 1968. Është dokument plotësues, i përkthyer në shumë gjuhë dhe i cili përshkruar të dhënat nga patenta e shoferit, që ka fotografi të drejtuesit të automjetit dhe të dhëna relevante mbi të drejtën për drejtim dhe i cili lëshohet nga MPB e Kosovës apo nga institucioni kompetent i autorizuar nga MPB e Kosovës. Ky dokument nuk i lejon pronarit të tij që ta drejtojë automjetin në vendin e origjinës.

Prandaj, unë konsideroj se ky projektligj tanimë është plotësisht në nivel që të bëhet një ligj i mirë dhe i ftoj deputetët, që ta votojnë me të gjitha amendamentet që i ka tani. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, të nderuar kolegë deputetë, për të qenë korrektë, ne e kemi rekomandimin e komisionit me 106 amendamente.

Pat reagim tash në amendamentin 56 po dua të them. Shkojmë e i votojmë 106 amendamente, por në rend të parë duhet votimi formal nga ana juaj, e përjashtojmë amendamentin 56 njëherë. Amendamentin 56 e votojmë veç. Vetëm dua votim formal, a pajtohemi për 105 amendamentet, këto jashtë 56-shit, t'i votojmë përnjëherë. Vetëm me ngritje dore, a jeni për? Kundër, kush është? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka. Një abstenim!

Atëherë, vazhdojmë. Po flasim për 105 amendamentet që do të votohen përnjëherë, vetëm amendamenti 56 po mbetet pa votuar.

Kush është për 105 amendamentet e propozuara nga... Cili? Edhe 29-shi mbetet jashtë. Atëherë për 104 amendamente. 29-shi e 56-shi mbeten për votim të veçantë. Kush është për të gjitha këto amendamente?

Atëherë shkojmë në mënyrë elektronike. Lus regjinë dhe deputetët të bëhen gati. Votojmë për 104 amendamente, përjashtohet amendamenti 29 dhe 56, për të cilët do të kemi votim, të veçantë. Votojmë tash?

Me 59 vota për, 4 abstenime e 2 kundër, votohen 104 amendamentet e propozuara nga Komisioni Funkcional.

Shkojmë tek amendamenti 29. Zoti ministër, urdhëroni fjalën për qartësime. Jemi tek amendamenti 29.

MINISTRI LUTFI ZHARKU: Deputetë të nderuar,
Kryetar,
Ministra,

Nëse bën për amendamentin 29, vetëm një ndryshim që ka të bëjë për të mos e lënë që një subjekt të organizojë trajnime, por le të jetë “subjekte”. Kemi të bëjmë me këtë, mënyra si është e shkruar po e lexoj: “Ministria mund të autorizojë ndonjë subjekt arsimor të akredituar”. Unë po kërkoj të jetë “Ministria mund të autorizojë subjekte arsimore të akredituara”, që të mos kemi probleme sa i përket Ligjit mbi konkurrencën. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Neni 26 ka vetëm një intervenim nga ministri i Transportit, në vend të “subjekt” të jetë “subjekte”. Atëherë, e votojmë vetëm nenin 26. Përgatitemi për votim në mënyrë. Amendamenti 29, më falni. Amendamenti 29, votojmë në mënyrë elektronike. Lus regjinë dhe deputetët, normalisht me vërejtjet e ministrit, në mënyrë elektronike, ju lutem votoni tash.

Me 58 vota për, 3 kundër dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 29 me ndryshimet e propozuara nga ministri.

Jemi tek amendamenti 56. Me vërejtjet e raportuesit, zotit Qela. Përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Me 56 vota për, 3 abstenime dhe 2 kundër, miratohet edhe amendamenti 56.

Tani votojmë tekstin e projektligjit në tërësi me amendamentet e propozuara. Zonja Sala, e ka... OK, mirë është. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Me 61 vota për, 2 abstenime dhe 2 kundër, Kuvendi e miratoi Ligjin për patentë-shofer.

Atëherë, rikthehem te:

12. Shqyrtimi i parë i Projektligjit nr. 05/L-96 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit

Fjalën e ka ministri i Financave, zoti Abdullah Hoti, që para deputetëve të prezantojë dhe arsyetojë ligjin. Urdhëroni, zoti ministër!

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryetar,

Të nderuar deputetë,

Ministra prezentë,

Lufta kundër terrorizmit lidhet ngushtë me programin e Qeverisë 2015/2018, konkretisht me objektivat për të parandaluar dhe për të luftuar terrorizmin dhe për bashkëpunimin me të gjitha vendet në luftën kundër terrorizmit.

Ky program parasheh aplikimin e një qasjeje pro-aktive për bashkëpunim ndërkombëtar, për parandalimin e pastrimit të parave, financimin e terrorizmit dhe krimeve të tjera financiare, si dhe zhvillimin e legjisllacionit kombëtar në përputhje me standardet ndërkombëtare në sigurimin e zbatimit efikas të tij.

Bashkëpunimi dhe ndërveprimi më i mirë, posaçërisht me Policinë dhe Prokurorinë në këtë drejtim është jetik. Krahasuar me ligjin aktual, që është në fuqi, ky projektligj i ka këto elemente kryesore:

1. Obligimi i subjekteve raportuese për të raportuar dyshimin lidhur me financimin e terrorizmit është sqaruar në këtë projektligj, duke përfshirë në mënyrë eksplicite financimin e terrorizmit në definicionin e aktit apo transaksionit të dyshimtë;

2. Projektligji ka paraparë rregullim të duhur për të siguruar se kazinotë dhe objektet e licencuara të lojërave të fatit ndalohen nga zbulimi i informatave për raporte të transaksioneve të dyshimta të dërguara në njësinë e Inteligjencës Financiare;

3. Projektligji inkuadron botëkuptimin, që të kuptuarit e qëllimit dhe natyrës së biznesit të klientit është pjesë e procesit të përgjithshëm të kujdesit të duhur ndaj klientit;

4. Projektligji ndryshon legjislacionin aktual për të garantuar implementimin e qasjes së bazuar në rrezik, para lansimit të produkteve të reja, praktikave biznesore apo përdorimit të teknologjive të reja apo të zhvillimeve të reja në këtë drejtim;

5. Projektligji ndryshon legjislacionin aktual me qëllim që të garantojë implementimin e programeve gjithëgrupore kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe gjithashtu, duke mbuluar degët e tyre të huaja dhe shumicën e filialeve në pronësi;

6. Dispozitat e përgjithshme kanë ndryshuar, pasi që nga subjektet raportuese kërkohet të identifikojnë, kuptojnë dhe zvogëlojnë rreziqet e tyre dhe të dokumentojnë dhe azhurnojnë vlerësimet e tyre të rrezikut;

7. Projektligji duhet të ndryshojë legjislacionin aktual për të definuar në detaje mbikëqyrjen e pajtueshmërisë dhe procedurës për sanksionimin administrativ të institucioneve raportuese, duke adresuar gjithashtu mandatin dhe përgjegjësinë e njësisë së Inteligjencës Financiare të Kosovës, Bankës Qendrore të Kosovës dhe autoriteteve të tjera mbikëqyrëse;

8. Projektligji e detajon procedurën për aplikimin e sanksioneve administrative kundër subjekteve raportuese për mospajtueshmëri me ligjin dhe për të harmonizuar procedurën për të ofruar udhëzim për praktikën e mira administrative dhe për ankesat kundër sanksioneve administrative të shqiptuara nga njësia e Inteligjencës Financiare;

Ndryshime, gjithashtu, reflektojnë kërkesat e domosdoshme për të siguruar se Njësia e Inteligjencës Financiare të Kosovës i bashkohet grupit ndërkombëtar EGMOND Group, të njësive të Inteligjencës Financiare në të cilat njësia e Inteligjencës Financiare të Kosovës ka aplikuar për anëtarësim qysh në vitin 2014.

Gjatë hartimit të projektligjit Ministria e Financave ka marrë parasysh edhe direktivën e BE-së nr. 2015/849 të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit për parandalimin e përdorimit të sistemit financiar për qëllime të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Unë ju falënderoj për vëmendje dhe ju ftoj që ta aprovoni këtë projektligj në leximin e parë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Të nderuar deputetë,

Pas prezantimit të projektligjit hap debatin për diskutim në parim. E ftoj kryetarin e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa, zotin Naser Osmani, që ta marrë fjalën.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Projektligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit përcakton masën, autoritetet kompetente dhe procedurat për zbulimin, parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

Çështjet kryesore që i adresohen këtij projektligji, që janë risi në krahasim me legjislacionin aktual, janë po ato që i përmendi ministri i Financave, që do të thotë obligimi i subjekteve raportuese për të raportuar dyshimin lidhur me financimin e terrorizmit, duke përfshirë në mënyrë eksplicite raportimin për financimin e terrorizmit në definicionin e aktit apo transaksionit të dyshimtë.

Projektligji ndryshon legjislacionin aktual për të garantuar implementimin e qasjes së bazuar në rrezik para lansimit të produkteve të reja, praktikave biznesore apo përdorimit të teknologjive të reja apo të tjera zhvillimore. Garantohej implementimi i programeve të gjithëgrupore kundër spastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe gjithashtu, duke mbuluar degët e tyre të huaja dhe shumicën e filialeve në pronësi. Definohet më në detaje mbikëqyrja e pajtueshmërisë dhe procedura për sanksionimin administrativ të institucioneve raportuese duke adresuar gjithashtu mandatin dhe përgjegjësitë e Njësisë së Inteligjencës Financiare, Bankës Qendrore dhe autoriteteve tjera mbikëqyrëse.

Projektligji e detajon procedurën për aplikimin e sanksioneve administrative kundër subjekteve raportuese për mospajtueshmëri me ligjin dhe për harmonizimin, procedurën për të ofruar udhëzim për praktika të mira administrative dhe për ankesat kundër sanksioneve administrative të ashtuquajtura nga NJIF.

Ajo që është e rëndësishme, projektligji adreson të gjeturat e raportit të progresit për vitin 2015, për avancimin e kornizës ligjore për parandalimin e shpëlarjes së parave dhe në luftimin e financimit të terrorizmit dhe miratimi i tij është i lidhur me kërkesa që dalin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit.

Komisioni për Buxhet dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 10.5.2016 e ka shqyrtuar në parim Projektligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit dhe ka vlerësuar se projektligji plotëson kushtet formalo-juridike të përcaktuara me Rregulloren e Kuvendit.

Komisioni ka pranuar disa vërejtje nga disa institucione që shprehin shqetësimin e tyre lidhur me rritjen e lartësisë së gjobave. Kërkesat formale për raportim për transaksione, përfshirjen e OJQ-ve si subjekte raportuese. Komisioni i rekomandon Kuvendit që ta miratojë projektligjin në

leximin e parë dhe duke pasur parasysh kohën e kufizuar, Komisioni për Buxhet dhe Financa do të takohet qysh nesër për të amendamentuar ligjin në fjalë, në kuptimin e asaj, që për të mërkurën e ardhshme për seancë të jetë i gatshëm me të gjitha amendamentet e projektligjit në fjalë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Tani kryetarët e grupeve parlamentare. E dëshiron dikush fjalën? Nga Partia Demokratike e Kosovës, Safete Hadërgjonaj, urdhëroni!

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L-96 për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit dhe ka ardhur në përfundim që ta miratojë rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa.

Plotësim-ndryshimi i ligjit apo tash që ka ardhur si ligj i ri, domethënë është bërë me qëllim që të evitohen parregullsitë dhe mangësitë ligjore në luftën për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Dispozitat e këtij projektligji janë të dizajnuara në atë mënyrë që të parandalohet apo të merren masat për parandalimin e tregut financiar nga keqpërdorimet për qëllime të financimit të terrorizmit.

Në këtë projektligj janë të përcaktuara të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar pastrimin e parave, procedurat, si dhe institucionet kompetente për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike do t'i analizojë me kujdes të gjitha vërejtjet, të cilat kanë ardhur nga institucionet përkatëse në lidhje me këtë projektligj, si dhe do të analizojë edhe rekomandimet që kanë ardhur në lidhje me pajtueshmërinë e këtij projektligji me ligjet e Bashkësisë Evropiane, sepse me deklaratën që na ka ardhur bashkëngjitur me këtë projektligj, thuhet se niveli i pajtueshmërisë është i pjesërishëm me ligjet e Bashkësisë Evropiane.

Ne do ta japim kontributin tonë në Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe u rekomandojmë deputetëve që ta përkrahin në lexim të parë këtë projektligj dhe ne të vazhdojmë me punën tonë, në mënyrë që me afatet që u miratuan këtu të jemi të gatshëm për miratimin përfundimtar të këtij projektligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zonja Hadërgjonaj! Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, urdhëroni zoti Hamiti!

SABRI HAMITI: Ligji është i domosdoshëm, i rëndësishëm, prandaj edhe morëm vendim që të kalojë sa më shpejt në parlament, meqë afatet janë të shkurtra. Unë vetëm po tërheq vëmendjen, që në këtë lexim, pas leximit të parë, në të dytin, të kihen parasysh posaçërisht neni 1.33.1; 1.33.2; 1.33.3 dhe neni 56. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Shpresoj se vërejtjet do të merren parasysh në leximin e dytë... Nga “Vetëvendosje” nuk ka, AAK nuk ka, Lista serbe nuk ka, “Nisma” nuk ka, as “6+”-i nuk ka të lajmëruar. Përfaqësuesi i Qeverisë nëse e kërkon fjalën!

Të nderuar deputetë,

Në vazhdim kërkohet deklarimi me votim për miratimin në parim të projektligjit. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se 59 deputetë kanë votuar për, ka 4 abstenime, asnjë kundër. Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit.

Kërkohet nga Komisioni Funkcional dhe komisionet e përhershme, që në përputhje me vendimin e seancës së sotme plenare ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara. Ftojme zëvendëskryetarin e Komisionit Funkcional për Mbikëqyrjen e Financave Publike, zotin Ali Sadriu, që para deputetëve ta paraqesë dhe arsyetojë raportin me rekomandime.

ALI SADRIU: I nderuar kryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Projektligji nr. 05/L-055 për Auditimin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës është miratuar në lexim të parë më datën 30 nëntor 2015. Kuvendi ka ngarkuar Komisionin për Mbikëqyrje të Financave Publike si Komision Funkcional dhe raportues për shqyrtimin e këtij projektligji.

Komisioni për Mbikëqyrje të Financave Publike ka caktuar grupin punues për shqyrtimin e projektligjit, ku kryesues ka qenë kryetari i komisionit, zoti Besnik Bislimi, por për shkak të bojkotit të opozitës, që nënkupton nga 9 anëtarë të komisionit, 3 bojkotojnë në start dhe 2 pastaj rriemërohen në komisione tjera, një kohë ka pasur pauzë dhe për çudi, komisioni nuk ka trashëguar asnjë dokument nga grupi punues i mëhershëm rreth hartimit dhe shqyrtimit të këtij ligji.

Megjithatë, komisioni me këtë vonesë ka autorizuar që zëvendëskryetari bashkë me anëtarët tjerë të komisionit bashkërisht të punojnë dhe ta finalizojnë këtë projekt.

Pas shqyrtimit të këtij projektligji ne kemi organizuar punëtori dyditore dhe kemi mbajtur disa takime. I kemi ftuar të gjitha grupet që kanë pasur interes për këtë projektligj dhe pas një pune të gjatë kemi hartuar një raport prej 18 amendamentesh, të cilat i kemi dërguar për shqyrtim në komisione të përhershme. Komisionet e përhershme të Kuvendit kanë dhënë vlerësimet e tyre dhe dy nga komisionet kanë propozuar edhe amendamente, ku shumica e tyre janë përkrahur nga

Komisioni Funkcional, ndërsa një amendament nuk ka përkrahje. Por, megjithatë kujtoj se në Kuvend do ta kemi miratimin dhe përkrahjen e të gjithëve edhe për këtë.

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike më datën 4 maj 2016 ka miratuar raportin përfundimtar me rekomandime për Projektligjin 05/L-055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës, andaj ftojme të gjithë deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës që ta votojmë këtë projektligj së bashku me amendamentet e Komisionit Funkcional. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Sadriu! Vazhdojmë me votimin e amendamenteve të propozuara sipas radhës të paraqitur në raportin e Komisionit Funkcional.

Sa deputetë i kemi? 63. Atëherë, votojmë!

Amendamenti 1. Kush është për? Do të shkojmë vetëm a ka kundër dhe abstenim.

Amendamenti 1

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 2

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 3

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 4

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 5

Janë dy propozime: E vë në votim propozimin e Komisionit Funkcional.

Votojmë në mënyrë elektronike.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Është propozimi i Komisionit Funkcional. Urdhëro, zoti Sadriu e ka kërkuar fjalën!

ALI SADRIU: Desha vetëm të përkujtoj se ky projektligj vjen për herë të dytë. Para dy vitesh po ashtu ka qenë në shqyrtim dhe në mungesë të disa sugjerimeve që i kemi marrë nga SIGMA të cilët na e përcjellin punën tonë dhe na japin standarde mbi të cilat ne veprojmë, atëherë ky ligj është shtyrë.

Pikërisht flet për pavarësinë funksionale dhe buxhetore të Zyrës së Auditorit dhe vetë Auditorit, prandaj propozimi ndoshta këtu ka pasur... por unë jam sqaruar me kryetarin e Komisionit të buxhetit dhe kam kënaqësinë se edhe ai e miraton këtë por sidoqoftë Komisioni ka pasur një mendim tjetër dhe i lus anëtarët e Komisionit për hir që ky ligj të funksionon dhe të veprojë, sepse deri tani ligji që ka ekzistuar ka qenë në kundërshtim me Kushtetutën e Kosovës, prandaj i lus deputetët që ta miratojnë versionin e Komisionit Funkcional.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Armend Zemaj e ka fjalën! Le të përgatitet Safetja!

ARMEND ZEMAJ: Unë desha të potencoj një çështje e cila, që po më duket vetëm se është stërzgjatur, e që ka të bëjë me Ligjin për pagat e zyrtarëve të lartë. Kjo është kërkesë e cila duhet sa më shpejt të rregullohet për shkak të këtyre dilemave e pengesave që na dalin neve si Kuvend pikësëpari, por edhe institucioneve që janë të pavarura dhe të garantuara për funksionimin e tyre edhe buxhetore me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Caktimi i pagës, duke krahasuar një institucion me një institucion tjetër, qoftë në përqindje, e kemi parë edhe në praktikë se më vonë ka dalë problematike. Shembull është caktimi i pagave të gjyqtarëve me pagat e ministrave dhe ju e dini që edhe sot e asaj dite çfarë pakënaqësish ka sepse lëvizjet që janë bërë në rritjen e pagave në Republikën e Kosovës, në pjesën tjetër kanë mbetur peng i këtyre normave të caktuara me ligj.

Prandaj, unë mendoj se kjo duhet të jetë kompetencë e Kuvendit për këtë kohë se sa caktimi i pagës me një institucion tjetër, sepse nëse kemi apo s'kemi lëvizje atje, në këtë anën tjetër mund të kemi dilema apo edhe pakënaqësi duke marrë parasysh rëndësinë që e ka Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të Republikës së Kosovës.

Unë mendoj se përpos mundësisë që ne të mos lëmë dilema në të ardhmen, Ligji për pagat e zyrtarëve të lartë po shihet se çdo ditë e më shumë është i nevojshëm në Republikën e Kosovës dhe kjo do t'i hiqte të gjitha dilemat.

Mirëpo, deri atëherë, duke marrë për bazë problematikat që kanë ndodhur me ligjet tjera kur kemi bërë krahasime apo kur kemi caktuar krahasime besoj se duhet të mbetet Kuvendi që të caktojë për këtë periudhë kohore deri sa të kemi ligjin për pagat e zyrtarëve të lartë. Faleminderit!

(Ndërrhyrje)

Që i bie, i dyti. Jo ai i Komisionit FunkSIONAL, por i Komisionit për Buxhet e Financa.

KRYETARI: Faleminderit! Zonja Hadërgjonaj dhe më pas zoti Osmani e ka kërkuar fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, kryetar!

Propozimi i Komisionit për mbikëqyrjen e financave publike ka qenë që neni 4, pas paragrafit 7 të shtohet paragrafi i ri me tekstin si vijon:

“Auditori i Përgjithshëm paguhet 90% nga paga dhe shtesa e kryetarit të Gjykatës Kushtetuese”

Kurse Komisioni për buxhet e financa nuk është pajtuar me një rekomandim të tillë. Ne, gjatë punës tonë në Komisionin për buxhet e financa, disa herë jemi përballur me një problem të tillë sepse shumë institucione të pavarura, qofshin ato edhe institucione kushtetuese, na kanë pru rekomandime të tilla dhe kanë insistuar që përmes neneve të caktuara të Ligjit t'i rregullojnë pagat e tyre.

Unë e kuptoj shumë çka do të thotë të funksionosh dhe punosh pa ligj për pagat e funksionarëve të lartë publikë, për çka disa herë edhe kam bërë pyetje në këtë Kuvend - pse nuk po vjen nga Qeveria Ligji për pagat e funksionarëve të lartë publikë. Ne i kemi mbi 33 institucione të pavarura të cilat për çdo ditë i bëjnë presion Komisionit për buxhet për ta zgjidhur këtë problem, që ka të bëjë me pagat e funksionarëve të lartë publikë dhe kurrë nuk e kanë kuptuar se pse ky projektligj nuk vjen në Kuvend dhe pse Kuvendi nuk e bën pastaj një grup të caktuar nga deputetët, nëse nuk vjen ligji nga Qeveria për ta hartuar ligjin përkatës.

Komisioni për buxhet e financa, ka marrë vendim unanim në Komision, pa asnjë votë kundër, që ky nen i propozuar nga Komisioni për mbikëqyrjen e financave publike të ndryshohet në këtë formë:

Neni 4, pas paragrafit 7, shtohen dy paragrafë të ri 8 e 9, në tekstin si vijon: “Niveli i pagës së Auditorit të Përgjithshëm caktohet me ligjin përkatës që rregullon pagat e funksionarëve të lartë publikë”.

Pika 9, thotë: “Deri në miratimin e ligjit përkatës që rregullon pagat e funksionarëve të lartë publikë, paga e Auditorit të Përgjithshëm caktohet nga Kuvendi”.

Paga e Auditorit të Përgjithshëm mund të caktohet shumë shpejt nga Kuvendi me një rekomandim i cili do vjen nga Komisioni për buxhet e financa, do t’i drejtohet Kryesisë dhe Kryesia e sjell në Kuvend dhe votohet paga e Auditorit të Përgjithshëm ashtu siç e kemi rregulluar problemin e pagës së Avokatit të Popullit dhe rregullohet edhe paga e Auditorit të Përgjithshëm deri sa të vjen ligji për pagat e funksionarëve të lartë publikë.

Prandaj, unë do të votoj rekomandimin e Komisionit për buxhet e financa që është votuar unanimisht në Komision dhe kërkoj nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës që të votojë për rekomandimin e Komisionit për buxhet e financa dhe njëherësh kisha kërkuar edhe nga anëtarët e Komisionit për buxhet të cilët e kanë votuar një herë të votojnë për dhe nga të gjithë deputetët të cilët janë prezentë në këtë seancë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Osmani e ka fjalën dhe le të përgatitet prapë zotëri Sadriu, pastaj është Arben Gashi dhe profesori Muhamet Mustafa.

NASER OSMANI: Faleminderit, zoti kryetar!

Kam pak të shtoj pas fjalës së zonjës Safete Hadërgjonaj. Ajo që është e vërtetë në praktikë, Komisioni po vjen në vështirësi të mëdha dhe momente kur po duhet caktuar pagën për institucione në mungesë të ligjit për pagat e zyrtarëve të lartë dhe kjo po ndodh me vite të tëra.

Si kryetar i Komisionit do ta kam shumë vështirë që ta caktoj pagën e ndonjë zyrtari që merr pagën nga buxheti i Kosovës i cili e ka pagën më të madhe se presidenti, se kryetari i Parlamentit dhe se kryeministri, prandaj është e domosdoshme që Komisioni të mos bjerë në këso situata, por të procedohet ligji sa më parë te ne.

Komisioni me unanimitet ka dhënë një propozim, atë që edhe e lexoi zonja Safete Hadërgjonaj i cili konsideroj se duhet të votohet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Sadriu e ka fjalën dhe le të përgatitet zoti Gashi!

ALI SADRIU: Faleminderit, zoti kryetar!

Problemi i pagave është një problem madhor dhe që trajtohet që disa vite dhe ne e dimë që ai ligj nuk është në horizont.

Këtë formë të formimit të pagës së zyrës së Auditorit nuk e ka dhënë Komisioni për mbikëqyrjen e financave publike. Ai e ka prezantuar si të tillë nga materiali që e kemi marrë prej SIGMA-s.

Edhe një herë po ju përkujtoj se një prej fundamenteve të rekomandimeve që na është dhënë pavarësia funksionale dhe buxhetore e tij. Prandaj, të gjitha sugjerimet tjera, ju lutem t'i kemi parasysh sepse ligji si i tillë, frikoj se nuk do të miratohet dhe ne do të vazhdojmë punën me avazin e vjetër.

Problemi tjetër është që Auditori deri para dy muajve ka qenë ndërkombëtar, në kuptimin e asaj që është zëvendësuar pastaj prej një zëvendësi që ka qenë aty dhe pagën e tij e ka paguar bashkësisht ndërkombëtare, nuk e ka paguar buxheti i Kosovës. Për herë të parë tani përcaktohet që të paguhet nga buxheti i Kosovës dhe formën - 90% të pagës ekuivalente të kryetarit të Gjykatës Kushtetuese nuk e kemi dhënë ne dhe po e përsëris, por e ka dhënë SIGMA. Prandaj ju lutem të keni mirëkuptim sepse kryetari i Zyrës së Auditimit që 2 muaj është pa pagë dhe zhegitjet nuk janë në interes të funksionit të këtij ligji që e rregullon këtë materie.

Një brengë që na ka mbetë është se nuk kemi arritur nga sugjerimet që i kemi marr nga partnerët ndërkombëtarë, duke dëshiruar që të kemi mirëkuptimin e të gjithëve, që Zyra e Auditorit të Përgjithshëm të auditojë edhe partitë politike, dhe si të tillë ne jemi të detyruar ta shmangim atë për të mos pasur pengesë.

Këtë nuk kemi mund ta shmangim, sepse unë mendoj që arsyet që i kanë ofruar janë tepër bindëse dhe si të tillë duhet ta pranojmë.

Është e vërtetë kjo që e tha zoti Naseri se ka paga që janë më të mëdha se e presidentit, por nuk është kjo e vetme, janë diku nga 30 a 40, a mos më shumë, që shkojnë në pagën deri në 5-6 mijë dhe ne shumë herë e kemi diskutuar këtë se është koha dhe rendi i fundit që dikush të ulet e ta shqyrtojë këtë çështje.

Unë nuk shoh përgjegjësi më të madhe se të presidentit, të kryetarit të Kuvendit, të Qeverisë, të kryeministrit dhe tjerë, prandaj në vazhden e tyre unë propozoj që si i tillë le të shkojë dhe kur të rregullohen të gjithë, le të rregullohet edhe ky. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë, zotëri Gashi e ka fjalën, dhe nuk po dua të ndërhyj, por ka qenë mirë ta përkufizojmë, sepse nga ne po u varka. Urdhëro, zoti Gashi!

ARBEN GASHI: Faleminderit, kryetar!

Unë nuk di pse po bëhet i tërë ky debat kur ka modele si janë zgjidhur këto punë. Dhe në aspektin funksional meqenëse është agjenci e pavarur apo institucion i pavarur, atëherë ne kemi rastin specifik të cilit mund t'i referohemi - Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe Ligji

për Agjencinë kundër Korrupsionit thotë: Paga e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kundër Korrupsionit është ekuivalente me pagën e kryetarit të Komisionit Parlamentar Mbikëqyrës për Agjencinë Kundër Korrupsionit.

Kjo do të ishte një zgjidhje elegante deri sa të nxirret ligji specifik për pagat e zyrtarëve të lartë dhe me ligjin specifik për pagat e zyrtarëve të lartë mund të vendoset që paga e drejtorëve bartës të agjencive të pavarura të jetë ekuivalente me njërin prej institucioneve tjera, dhe rregullohet kjo punë.

Prandaj, mendoj se është rasti që ne të përdorim një analogji dhe në këtë rast kemi të bëjmë me analogjinë me Agjencinë Kundër Korrupsionit e cila e ka të përcaktuar me ligj pagën dhe nuk ka nevojë për të gjitha këto debate të nxjerr një vendim tjetër specifik Kuvendi dhe të vendosë në mënyrë specifike se sa me ia dhënë pagën dikujt, por vendoset me analogji dhe kjo çështje zgjidhet. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Mustafa e ka fjalën!

MUHAMET MUSTAFA: Pikërisht desha të tërheq vërejtje se sado që duket kjo çështje teknike, kjo është çështje esenciale. Domethënë kemi të bëjmë me një organ i cili e ka një rëndësi jashtëzakonisht të madhe për mbikëqyrjen e përdorimit të aseteve publike dhe financave publike dhe ai duhet të ketë pavarësi të plotë duke përfshirë edhe pagën.

Prandaj, mendoj që është krejtësisht me vend që të ndërlihet dhe në mënyrë automatike të dihet paga dhe kur të vjen ligji ato mund të merren si të tilla e që në mënyrë automatike të lidhet paga e një funksioni me funksionin tjetër, por deri sa të vjen, meqë kemi edhe praktika të tilla, mendoj se duhet të aprovohet amendamenti që e ka propozuar Komisioni funksional sepse ka të bëjë me esencën e funksionit dhe rolit të Auditorit të Përgjithshëm. Faleminderit!

KRYETARI: Atëherë vazhdojmë me votim. Janë dy propozime për amendamentin 5.

Në rend të parë do të votojmë në mënyrë elektronike për propozimin e parë – Propozimin e Komisionit funksional.

Ju lutem, le të ftohen deputetët të vijnë në sallë!

Në ndërkohë, unë po e lexoj propozimin e Komisionit Funksional si vijon:

Neni 4, pas paragrafit 7, shtohet paragrafi i ri me tekstin si në vijim: “Auditori i Përgjithshëm paguhet 90% nga paga dhe shtesa e kryetarit të Gjykatës Kushtetuese”.

Tash do të lexoj përmbajtjen nën b): Propozimi i Komisionit për buxhet dhe financa, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Neni 4, pas paragrafit 7, shtohen 2 paragrafë të ri 8 dhe 9, me tekstin si vijon:

“8. Niveli i pagës së Auditorit të Përgjithshëm caktohet me Ligjin përkatës që rregullon pagat e funksionarëve të lartë publikë”.

9. Deri në miratimin e ligjit përkatës që rregullon pagat e funksionarëve të lartë publikë, paga e Auditorit të Përgjithshëm caktohet nga Kuvendi”.

Pra, nëse kalon propozimi b), atëherë ne duhet ta shtojmë këtë dhe t’ia përcaktojmë pagën, sepse kryetari i Kuvendit nuk e bën atë, por e bën vetë seanca.

(Ndërrhyrje)

Komisioni e bën! Këto dy propozimet i lexuam dhe shkojmë në të parën dhe dytën, e kur dalim te propozimi b) ne do ta fusim edhe një paragraf të shkurtër që Komisioni për buxhet e financa e përcakton pagën.

S’ka nevojë, a? Atëherë, u krye e mos të jetë kryetari i Kuvendit.

Votojmë për propozimin e Komisionit funksional. Regjia dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

20 deputetë janë për, 34 janë kundër dhe 7 abstenojnë, nuk kalon propozimi.

Kalojmë në propozimin e dytë.

Propozimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

A ka nevojë të lexohet edhe një herë? Nuk ka nevojë!

Atëherë lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Pra, me 47 vota për, 9 abstenime dhe 7 kundër kalon amendamenti 5, me propozimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa, pa përkrahjen e Komisionit Funksional.

Amendamentin 6

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 7

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 8

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 9

Kundër? Nuk ka. Abstenim nuk ka. Miratohet.

Amendamenti 10 deri në 18, nëse pajtoheni i votojmë në paketë, e nëse keni vërejtje mos i votoni.

A ka kush kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Tash e votojmë tekstin e Projektligjit në tërësi, me amendamentet e miratuara. Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Atëherë, me 60 vota për dhe 1 abstenim, Kuvendi e miratoi Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën e Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës.

Jemi te pika e rendit të ditës:

8. Votimi i anëtarëve të Bordit Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit

Të nderuar deputetë,

Diskutimet për këtë pikë si dhe pikat në vazhdim 9, 10 dhe 11 kanë përfunduar në seancën plenare të mbajtur me 29 prill 2016, andaj në seancën e sotme procedojmë vetëm me votimin e tyre.

Para se të procedojmë me votimin e kësaj pike, ju njoftoj se kandidati i propozuar për anëtarë të Bordit Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit, zoti Naser Sahiti ka dhënë dorëheqje nga propozimi për emërim në këtë bord.

Në mbështetje me nenin 60 të Ligjit për mbrojtjen e mjedisit dhe në pajtim me rekomandimin e Komisionit për Bujqësi dhe me propozim të Qeverisë së Kosovës Kuvendi i zgjedh anëtarët e Bordit Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit, si në vijim:

- Profesor doktor Behxhet Mustafa,
- Profesor doktor Naser Ramadani,
- Profesor doktor Islam Fejza,
- Dotore e shkencave Nusrete Doda-Gashi,
- Tush Markaj, dhe
- Fatos Lajçi.

Vazhdojmë me procedimin me votim për emërimin e anëtarëve të Bordit Këshillëdhënës për mbrojtjen e Mjedisit.

Më falni se në ndërkohë u paraqit zonja Duda Balje për të diskutuar!

DUDA BALJE: Faleminderit! Ono što sam ja i prošle sednice obavestila, što se tiče ovog Borda, jeste da jedan član Borda, profesor Naser Sahiti dao otkaz. Znači on je dao otkaz odnosno ostavku i povuao se sa te pozicije, ja sad molim Parlament, ukoliko je to u skladu sa Poslovníkom Skupštine da se glasaju ove šest osobe koje su ovde u Bordu, a da Vladi ostavimo da donese još jedno ime naknadno. I naravno, mi apelujemo da to bude osoba iz manjinske zajednice pošto su to 6 iz većinske.

KRYETARI: Faleminderit zonja Balje! Nuk ka problem, e qartësuam dhe po procedojmë me votim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Atëherë, me 12 vota për, 13 abstenime dhe 36 vota kundër, konstatoj se Kuvendi nuk i zgjodhi anëtarët e Bordit Këshillëdhënës për Mbrojtjen e Mjedisit.

Jemi në pikën e radhës:

9. Votimi i raportit të Komisionit për Integritet Evropian lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

(Ndërrhyrje)

Atëherë, le të lutem deputetët të kthehen në sallë dhe të votojmë. Është në dorën tuaj, e vendosni si seancë, kam dëgjuar se mëditjet kanë shumë efekt dhe vetëm ua heqim mëditjet dhe më thanë se do të vijnë 120 deputetë!

Unë kisha propozuar, ndoshta jo sot, por po e shoh se deri në orën 11:00 nuk po vjen një pjesë e madhe, prandaj siç po punojmë edhe i kemi punët, e pastaj nënshkruhen dhe ikin. 73 deputetë kanë qenë në orën 10:20 të nënshkruar dhe në sallë gjithmonë janë më pak, e s'po u lë përshtypje kjo çfarë po flasim. E kur i bëjnë listat zgjedhore, këta deputetë, me treguar se asnjëri me zor nuk ka ardhur, por ka insistuar.

Si do që të jetë, a e votojmë edhe një herë. Është çështje e debatit të gjerë kjo. Atëherë edhe një herë e votojmë Raportin e Komisionit për Integritet Evropian lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale.

Janë 64 deputetë në sallë dhe lus regjinë e deputetët të përgatiten për votim. Votojmë tash!

Konstatoj se me 62 për, 1 kundër dhe 1 abstenim, Kuvendi e miratoi raportin me rekomandimet e Komisionit për Integritet Evropian lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për kompetencat e zgjeruara për konfiskimin e pasurisë së fituar me vepër penale.

10. Votimi i raportit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologjik, Kulturë, Rini dhe Sport lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës

Para se të votojmë, fjalën e kërkon Nait Hasani!

NAIT HASANI: Faleminderit kryetar!

Çështja e raporteve të monitorimit të ligjeve, mesa kemi vërejtur ne si Komision, angazhimi ynë njëvjeçar në përcjelljen e Ligjit për arsimin parauniversitar, por edhe komisionet tjera që i kanë

nxjerrë rekomandimet e ndryshme për zbatimin apo moszbatimin e ligjeve dhe neneve brenda ligjeve, tregon se këto vizita, këto monitorime nuk e kanë efektin e duhur dhe duke mos e pasur këtë, po kërkojmë që nëpër komisione mos të merren me monitorime të ligjeve për shkak se efektet e tyre janë zero.

Kur e them këtë kam parasysh se ne vizitojmë, bëjmë rekomandime dhe këto rekomandime nuk i këqyrë kush, nuk interesohet kush, nuk i realizojnë prandaj e kotë është të miratojmë rekomandime kur nuk janë të përgjegjshëm organet e Qeverisë.

Deri sa kërkojmë e bëjmë zgjedhjen ose përzgjedhjen e rekomandimeve të cilat nëpër nene janë të moszbatueshme, atëherë e kotë është që i themi Kuvendit miratoje këtë rekomandim sepse do ta përmirësojë gjendjen.

Në vazhdimësi, të gjithë ministrat e Qeverisë bien ligje për t'i përmirësuar, por asnjëherë nuk mendojnë që ta përmirësojnë kualitetin apo njerëzit atje që i bëjnë shkeljet e ligjeve.

Për derisa nuk merret Qeveria me përmirësimin e organeve të veta atje, kot ne ndryshojmë e miratojmë apo zgjedhim ligje.

Ju kam thënë se Qeveria po tregohet shumë e papërgjegjshme në zbatimin e ligjeve dhe këtë e bën pikërisht për shkak se një Kuvend është jo funksional, jo funksional sepse e ka marrë veten me shaka, me thashetheme dhe merret me politika ditore.

Çështjet e politikave ditore, në zbatueshmërinë e ligjeve dhe të ministrave, janë kundërproduktiv dhe e tregojnë gjendjen ku e ka Kosova sot.

Ta miratosh një projektligj të arsimit parauniversitar kur arsimi është në pikën shumë të vështirë ose elementi kryesor i funksionimit të shtetit dhe të ndërtimit të një gjenerate të re, atëherë rekomandimet dalin jo interesante për institucionet të cilat atje janë.

Po kërkojmë që të gjitha rekomandimet që i ka nxjerrë Komisioni dhe vërejtjet që i kanë dhënë deputetët, po ashtu si kërkesë që të shtohen rekomandime për t'u plotësuar, edhe ato kërkesa që është kërkuar të hiqen, po ashtu... prandaj këto rekomandime të Komisionit për arsim për ligjin parauniversitar të miratohen, por të kërkohet një përgjegjësi nga ministrat ose të kërkohen interpelancë e ministrave, që ata të përgjigjen dhe të japin përgjegjësi për zbatimin e moszbatimin e ligjeve. Faleminderit!

(Drejtimin e mbledhjes e merr nënkryetari i Kuvendit, z. Sabri Hamiti.)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Hasani! Dua të ma jepni numrin e njerëzve që janë këtu. Ju lutem, po e votojmë raportin e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës.

Regjia të bëhet gati, i kemi 64 deputetë të pranishëm. Votojmë tash: 58 janë për, 5 kundër dhe 1 abstenim. Kalon raporti, votohet.

11. Votimi i raportit të performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2014

Ju lutem, bëhuni gati. Votojmë tash!

Kanë votuar 64 deputetë. 55 për, 2 kundër dhe 7 abstenim. Është votuar raporti i performansës së ndërmarrjeve publike për vitin 2014.

14. Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit për Ankesa të Medieve

I ftoj kryetarët përfaqësues të grupeve parlamentare t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc.

Komisioni përbëhet prej 9 anëtarëve. E ftoj kryetarin e Grupit Parlamentar të PDK-së që ta propozojë një deputet për kryetar të Komisionit dhe një deputet për anëtar të Komisionit.

ADEM GRABOVCI: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, e propozon për kryetare Xhevahire Izmakun. Ju lutem, është eksperte e kësaj pune dhe nuk mund ta ndërrojmë, dhe Hajdar Beqën si anëtar.

KRYESUESI: Lidhja Demokratike e Kosovës? Unë e kam një letër këtu, a janë këta? Për anëtarë i propozon deputetet Alma Lama dhe Melihate Tërmkollli.

Grupi Parlamentar "Vetëvendosje" nuk është këtu, Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës nuk është këtu. Grupi Parlamentar i Listës serbe e propozon një deputet për zëvendëskryetar të dytë të Komisionit. Lista serbe, Sërgjan Popoviq.

SRĐAN POPOVIĆ: Adem Hodžaj će biti.

KRYESUESI: Grupi "Nisma" nuk është. Fjalën e kërkon Alma Lama. Një moment, Grupi "6+".

DUDA BALJE: Mi predlažemo gospodina Kujtim Pačaku.

KRYESUESI: Atëherë të gjitha grupet që janë këtu kanë propozuar. Alma Lama, Urdhëro!

ALMA LAMA: Faleminderit, i nderuar kryesues!

Unë kërkoj nga ju si kryesues, por edhe nga sekretari që ta interpretojnë pak Rregulloren. Pse duhet që këto komisionet ad hoc që në mënyrë të vazhdueshme t'i kryesojë PDK-ja, mendoj që kjo duhet të bëhet me radhë, domethënë dy partitë e mëdha. Nuk ka lidhje me emra, po në mënyrë të vazhdueshme i kryeson PDK-ja. Rregullorja nuk e thotë këtë, duhet që të kryesohen me radhë. Këtë vërejtje e kisha. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, unë jam duke e drejtuar një seancë të Parlamentit dhe këtu jam tash krejt neutral dhe duhet të jem i tillë dhe duhet të jetë secili që ulet këtu. Ju jeni partnerë të koalicionit dhe merrni vesh, nëse ju thoni, unë ju them ashtu. Atëherë ja ku i keni, unë këtu jam në këtë rast duke e drejtuar seancën e Parlamentit, e jo një parti. Merrni vesh ju, është punë

juaja nëse do ta bëni kryetar një të LDK-së, apo të PDK-së. Rregullorja është rregullore, që e vendos Parlamenti. A keni komente ju të tjerët? Votojmë formalisht me dorë për këto grupe. Faleminderit! A ka kundër? Një kundër. Për veten je kundër?. Faleminderit! Shkojmë tutje!

15. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2015

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar raportin e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin financiar të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Selvije Halimi, nënkryetare e Komisionit Funkcional, e merr fjalën për arsyetimin e raportit me rekomandime. Urdhëro!

Atëherë, në emër të këtij Komisioni, Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, në cilësinë e Komisionit Funkcional, duke u bazuar në nenin 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 19. 4. 2016, e ka shqyrtuar raportin e punës së Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2015.

Raporti i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2015 u vlerësua se është i kompletuar, po ashtu edhe pjesa buxhetore për raportin financiar për vitin 2015 për këtë agjenci u vlerësua që është më e ulët se sa e agjencive tjera dhe anëtarët e Komisionit vlerësuan bashkërisht se me këtë buxhet nuk ka mundur dhe nuk mund t'i realizojë përgjegjësitë që i ka dhe që dalin nga ligjet e aplikueshme.

Andaj, Komisioni i jep përkrahje raportit në fjalë me rekomandimet që kanë dalë nga ky takim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Në emër të grupeve parlamentare, kush e do fjalën? Naser Osmani në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryetar!

Agjencia për Ndihmë Juridike Falas e ka dorëzuar në Kuvend raportin vjetor financiar për vitin 2015 sipas të dhënave të kërkuara.

Raporti i pasqyron të dhënat për buxhetin e miratuar, ndryshimi që ka ndodhur gjatë vitit, si dhe të dhënat për shpenzimin e buxhetit sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike dhe krahasimet në vitet paraprak.

Buxheti fillestar i ndarë për Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2015 ka qenë 306 357 euro, ndërkaq buxheti përfundimtar ishte 289 497 euro. Duke përfshirë ndryshimin që ka

ndodhur me rishikimin e buxhetit dhe shkurtimet sipas vendimit të Qeverisë, nga kjo shumë janë shpenzuar 287 557 euro, apo 99,33%.

Buxheti i shpenzuar sipas kategorive ekonomike ka qenë për paga dhe mëditje 100%, mallra dhe shërbime 98,36%, shpenzime komunale 100%, ndërkaq nuk ka pasur buxhet të ndarë për subvencione dhe transfero dhe investime kapitale.

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 27. 4. 2016, pasi e shqyrtoi raportin vjetor financiar të Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas për vitin 2015 vlerësoi se raporti përmbush obligimet ligjore për raportim që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe i rekomandon Kuvendit për votim. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Unë e kam një sugjerim për deputetët. Nëse jemi të disiplinuar edhe në sallë, edhe në bisedime, ky rend dite mund të kryhet edhe para drekës. Kjo varet prej jush. Fjalën e ka Agim Aliu... Deputeti Çoçaj e ka fjalën.

NEZIR ÇOÇAJ: I nderuar zoti nënkryetar i Kuvendit,
I nderuar ministër,
Të nderuar kolegë deputetë,
Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin vjetor të Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas për vitin 2015 dhe si i tillë vlerësojmë se duhet të mbështetet nga deputetët.

Duke iu referuar këtij raporti, Agjencia ka siguruar qasje të barabartë për të gjithë qytetarët në sistemin e drejtësisë, sidomos kur e kemi parasysh situatën ekonomike sociale të qytetarëve tanë, e posaçërisht të kategorive sociale, të cilat nuk kanë mundur ta realizojnë këtë të drejtë për ndihmë juridike falas.

Rol të konsiderueshëm në funksionalizimin e kësaj agjencie kanë dhënë edhe donatorët e jashtëm, të cilët me mbështetjen financiare dhe profesionale kanë bërë që kjo agjenci të jetë në stadin ku është sot.

Mirëpo, duhet të theksohet se mbështetja financiare nga muaji qershor i vitit 2015 ka pasur rënie dhe nga kjo ka rezultuar që dy zyrat, në Gjakovë dhe Ferizaj, të mbyllën.

Me mbylljen e këtyre dy zyrave ka rezultuar që të kemi 1 008 raste më pak në shqyrtim nga viti paraprak. E për rifunksionalizim të këtyre dy zyrave duhet mbështetje financiare në shumën prej 48 mijë eurove në vit.

Ne si grup parlamentar i bëjmë thirrje Qeverisë që sa më shpejt që të jetë e mundur të sigurohen mjete për rifunksionalizimin e këtyre dy zyrave dhe për hapjen e zyrave të reja, apo të zyrave mobile, me qëllim të ofrimit të shërbimeve për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës.

Agjencia për Ndhimë Juridike Falas është kategori juridike kushtetuese dhe si e tillë duhet të përkrahet sa më shumë nga të gjitha institucionet e shtetit dhe si e tillë do të mbështetet fuqishëm edhe nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës. Faleminderit!

KRESUESI: Faleminderit! Agim Ademaj e ka fjalën.

AGIM ADEMAJ: Faleminderit, nënkryetar!

Përsëritje për të pranishmit,

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar raportin e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2015 dhe konsideron se ai i plotëson kriteret raportuese dhe është i kompletuar me të dhëna që paraqesin punën dhe vështirësitë në punën e kësaj agjencie.

U tha edhe më herët, mbetet brengosës mosfunksionalizimi i zyrave në Ferizaj dhe në Gjakovë dhe është rekomandim i përkrahur nga Grupi Parlamentar i LDK-së që këto dy qendra, ose këto dy zyre të funksionalizohen sa më parë.

Vëmendje e posaçme duhet t'i kushtohet edhe një pilot-projekti që është në zbatim e sipër, që ka të bëjë me metodën mobile të ofrimit të kësaj ndihme, e që nëse tregohet efikase mund të përdoret për një numër të caktuar komunash për arsye të ndryshme.

Duhet provuar që në tri qendrat regjionale, Prishtinë, Pejë dhe Mitrovicë, të vendosen këto zyra në objekte publike, që të mos paguhet qiraja dhe ato mjete mund të përdoren në këtë agjenci për punë të tjera.

Si do që të jetë, Grupi Parlamentar i LDK-së e përkrah këtë raport të punë së agjencisë dhe i ftoj kolegët që ta votojnë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Deputeti Abdyl Ymeri e ka fjalën.

ABDYL YMERI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Ndihma juridike falas për qytetarët të cilët nuk kanë mundësi materiale, si personat me nevoja të veçanta, me asistencë sociale, gratë e moshuara dhe grupet tjera të ndjeshme të shoqërisë realizohet nëpërmjet Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, e cila është përgjegjëse për sigurimin e ndihmës juridike falas në lëmin civil penal administrativ dhe kundërvajtës për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës në bazë të parimit të mosdiskriminimit ndaj asnjë personi, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike, apo dallimet tjera.

Duke i identifikuar nevojat e qytetarëve të komunave Gjakovë, Ferizaj, Skenderaj, Klinë, Killokot, Dragash, Graçanicë, Mitrovicë e Veriut, si dhe duke pasur parasysh pamundësinë e mbrojtjes dhe realizimit të të drejtave të tyre dhe largësisë territoriale nga zyrat ekzistuese të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, UNDP-ja nëpërmjet donatorëve të saj dhe projektit "Qasje në drejtësi" i financoi për 5 vjet me radhë këto zyra në komunat e lartcekura, duke vazhduar punën e tyre edhe për 6 muaj të mbështetura nga Ambasada norvegjeze.

Pas përfundimit të programit për financim nga UNDP-ja dhe Ambasada norvegjeze, këto zyra janë mbyllur dhe mundësia për qasje të barabartë në drejtësi dhe ndihmë juridike falas për kategoritë e qytetarëve që kanë mungesa të mjeteve materiale, si dhe grupeve më të rrezikuara dhe më të ndjeshme të shoqërisë sonë u është vështirësuar kjo mundësi, duke marrë parasysh

mundësitë e tyre financiare dhe largësinë territoriale, sepse nga pamundësia e tyre e mjeteve materiale u janë mohuar të drejtat atyre.

Unë konsideroj se Agjencia për Ndhimë Juridike Falas si agjenci e pavarur duhet mbështetur fuqishëm në realizimin e misionit dhe vizionet e tij, duke mbështetur në ngritjen e kapaciteteve të tanishme dhe kapaciteteve të reja, në veçanti në profesionalizimin e ndihmës juridike falas.

Agjencia për Ndhimë Juridike Falas i ka zyrat e veta në regjionin e Prishtinës, Mitrovicës, Gjilanit, Pejës, Prizrenit, por këtu mungojnë edhe zyrat në regjionin e Ferizajt dhe Gjakovës për mungesë të mjeteve financiare.

Prandaj, Kuvendi dhe Qeveria duhet ta kenë parasysh kërkesën e arsyeshme të agjencisë për ndihmë juridike falas dhe duhet ndihmuar financiarisht për t'i hapur këto dy zyra, sepse nga informatat që kam ato mund të hapen me një mbështetje financiare prej 40 mijë eurove brenda një viti. E pse të mos hapen edhe në Skenderaj e në Klinë dhe në ato komuna ku ka mundësi financiare?

Raporti në tërësinë e tij është përmbajtjesor, është një raport analitik dhe e ka një strukturë mirë të ndërtuar, që paraqet secilin aktivitet dhe punë që kryen agjencia, dhe në mënyrë detale paraqiten të gjitha të dhënat e buxhetit të planifikuar dhe të realizuar.

Unë e përgëzoj agjencinë për raportin dhe për punën që e bën. Faleminderit!

KRYESUESI: I fundit është Agim Aliu.

AGIM ALIU: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,
I nderuar ministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Raporti vjetor i vitit 2015 i Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas vlerësoj se është një raport që duhet aprovuar nga Kuvendi, pasi është bërë një punë e mirë e agjencisë për të siguruar një qasje sa më të gjerë dhe efektive të qytetarëve tanë në sistemin e drejtësisë.

Kjo ndihmë juridike falas nga kjo agjenci meriton vlerësim dhe përkrahje edhe për faktin se është shtrirë në një pjesë të konsiderueshme të komunave të Republikës së Kosovës, por njëkohësisht mungon në disa prej tyre kjo ndihmë juridike, edhe pse është kategori kushtetuese dhe është e drejtë e garantuar, pasi Kushtetuta e Republikës e përcakton këtë.

Duke pasur parasysh këtë fakt, prandaj do të duhej përkrahje më e fuqishme që duhet dhënë kësaj agjencie, në mënyrë që në mes të pamundësisë financiare dhe të drejtës kushtetuese të sigurohet sa më shumë përkrahje për qytetarët tanë që t'i ushtrojnë të drejtat e tyre.

Përveç rolit ligjor dhe kushtetues, Agjencia për Ndhimë Juridike Falas është duke mundësuar vazhdimisht edhe ngritjen e vetëdijes juridike të ushtrimit të një të drejte nga qytetarët tanë, duke pasur parasysh faktin se nuk ka pasur një veprim të tillë juridik në të kaluarën dhe tashmë gjithnjë e më shumë kemi veprimtari të tilla juridike nga qytetarët tanë.

Agjencia u ka mundësuar shumë qytetarëve përkrahje në shumë lëndë dhe është pjesë e punës së tyre që është paraqitur në këtë raport vjetor për vitin 2015, por sigurisht që kanë mbetur edhe shumë lëndë edhe shumë qytetarë pa përkrahje në pamundësi të përkrahjes së duhur të kësaj agjencie në aspektin buxhetor që të paraqet sfidën kryesore të saj.

Punët që ka bërë kjo agjenci janë bërë më të lehta falë mbështetjes nga Ambasada e Norvegjisë, UNDP-ja, OSBE-ja dhe në këtë rast duhet shprehur falënderim për të gjithë ata që e kanë mbështetur punën e saj.

Mirëpo, tashmë kjo mbështetje është ndërprerë dhe që nga 10 qershori 2015 edhe më shumë është vështirësuar funksionimi më i mirë, më kualitativ dhe më i gjerë i kësaj agjencie, dhe me këtë do të ketë më pak mundësi për t'u shërbyer juridikisht qytetarëve tanë.

Komisioni për Legjislacion i kishte kuptuar me të drejtë sfidat dhe vështirësitë në raportin e kaluar të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, prandaj u kishte rekomanduar Kuvendit dhe Qeverisë që të përkrahet më shumë ky institucion, gjithmonë duke pasur parasysh punën që ka bërë dhe atë që ka synim ta bëjë.

Mirëpo, fatkeqësisht, vështirësitë e kësaj agjencie kanë mbetur po të njëjtat për shkak të mospërkrahjes nga Qeveria.

Konsideroj se mbështetja e kërkuar financiare nga agjencia është e drejtë dhe e mundur për t'u realizuar, sepse është kërkesë tepër modeste për një buxhet të Republikës dhe vetëm me një shkurtim buxhetor të shpenzimeve të panevojshme nga pozicionet e caktuara buxhetore mund të sigurohet shuma prej 24 mijë eurove për një zyrë, në fakt gjithsej 48 mijë euro për dy zyrat regjionale, që do të mjaftonin të hapeshin ato në Ferizaj dhe në Gjakovë.

Tashmë shumë institucione të tilla të përfaqësimit regjional funksionojnë në këto dy qytete regjionale dhe kjo do të duhej të ndodhte edhe me këtë agjenci.

Duke qenë kështu, kërkoj që Qeveria dhe Kuvendi me mundësitë e ardhshme të planifikimeve buxhetore ta mbështesin kërkesën financiare të kësaj agjencie.

Duke e vlerësuar edhe një herë punën e kësaj agjencie, me gjithë këto vështirësi dhe sfida, por edhe duke besuar se rekomandimet që bëmë sot nuk do ta kenë fatin e atyre paraprake, por vërtet do ta mbështetin punën e agjencisë, me çka do të tregojmë se vërtet i mbështetim qytetarët tanë, si dhe respektojnë Kushtetutën e Republikës, kërkoj nga deputetët e këtij Kuvendi që ta miratojnë këtë raport të agjencisë, si dhe rekomandimet e paraqitura. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk ka diskutues tjerë. Duke i pritur deputetët kalojmë në pikën 17.

17. Shqyrtimi i raportit financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Komisioni Funkcional për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Fjalën e ka Abdullah Hoti, ministër i Financave. E kam kaluar me qëllim një pikë, sepse duam ministrin ta kemi këtu. Urdhëro!

MINISTRI ABDULLAH HOTI: Faleminderit, kryesues!

E vlerësoj shumë që e futët në rend të dite këtë, e tejkaluat rendin për pak. E vlerësoj shumë.

I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë po paraqes para jush raportin vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin fiskal 2015.

Ky raport prezanton ekzekutimin e Buxhetit nga institucionet e Republikës së Kosovës.

Në dhjetor 2014, Kuvendi i Kosovës e ka aprovuar Ligjin numër 05/L-001 për ndarjet buxhetore të vitit 2015, si dhe Ligjin numër 05/L-046, kur plani vjetor i pranimeve për vitin 2015 ka qenë 1 750 681 000 euro dhe plani vjetor i pagesave ka qenë 1 722 138 000 euro, duke përfshirë edhe të hyrat tjera vetjake të bartura nga viti 2014 në vitin 2015.

Më lejoni shkurtimisht të prezantoj pranimet buxhetore dhe shpenzimet.

Pranimi gjatë vitit 2015, duke mos përfshirë grantet e përcaktuara të donatorëve, kanë qenë 1 690 000 000 dhe paraqesin 97% të pranimeve të përgjithshme vjetore të planifikuara.

Doganat kanë mbledhur 951,8 milionë euro dhe kanë realizuar planin e tyre për 101%.

Administrata Tatimore ka mbledhur 332,7 milionë euro, apo 98% e planit vjetor, rritja krahasuar me vitin e kaluar në këto dy agjenci ka ardhur si rezultat i vlerësimit më të mirë të mallrave, i luftimit të ekonomisë informale dhe rritjes së aktivitetit biznesor në vend.

Të hyrat jostatimore kanë qenë në vlerë prej 49,4 milionë euro, që është 101% e planit vjetor.

Të hyrat vetjake të nivelit qendror kanë arritur 49,3 milionë euro, që është 123% e planit vjetor.

Të hyrat vetjake të komunave janë realizuar vetëm 78% dhe kanë arritur 57,8 milionë euro.

Kemi pasur të hyra nga taksa koncesionare në vlerë prej 6,5 milionë euro.

Nga tantiema 29,7 milionë euro.

Të hyrat e dedikuara nga AKP në vlerë prej 5,5 milionë euro.

Nga dividenta kemi inkasuar 15 milionë euro.

Huazimi nga institucionet financiare ndërkombëtare kanë qenë 45,4 milionë euro.

Nga letrat me vlerë kemi inkasuar 121,2 milionë euro dhe nga financimi i menjëhershëm i AKP-së nga privatizimi i ndërmarrjes shoqërore kemi inkasuar 61,3 milionë euro.

Sa u përket pagesave buxhetore gjatë vitit 2015, duke mos përfshirë grantet e donatorëve dhe fondet në mirëbesim kemi pasur një miliard e 597,9 milionë euro, që është 93% e pagesave vjetore të planifikuara.

Te pagat dhe rrogat kemi shpenzuar 524,9 milionë euro, apo 94% të planit vjetor, ndryshe është 33% e shpenzimeve totale.

Në mallra dhe shërbime janë shpenzuar 11% e të gjitha shpenzimeve në nivel vendi, në vlera absolute janë 182 milionë euro, në shpenzime komunale janë shpenzuar 24,1 milionë euro, që është 1% e shpenzimeve të përgjithshme, për subvencione dhe transfere kemi shpenzuar 418 milionë euro, që është 26% e shpenzimeve të përgjithshme.

Në këtë rast e jap edhe një sqarim për deputeten Gaxherri, e cila në Komisionin për Buxhet dhe Financa ka kërkuar informata shtesë se çka përfshihet në subvencione dhe transfere tek zëri buxhetor buxhetor ristrukturimi i potencialit fizik në vlerë prej 14,9 milionë euro. Këtu përfshihen subvencionet dhe grantet e ndara për bujqësi në bazë të planit për bujqësi për bujqësi dhe zhvillim rural, 2014-2020.

Shpenzimet kapitale kanë qenë 403,8 milionë euro, që është 25% e shpenzimeve të përgjithshme dhe kemi shpenzuar 44,8 milionë euro për servisim të bordit, që është 2,8% e shpenzimeve të përgjithshme vjetore.

Gjendja e fondeve më 31 dhjetor 2015 ka qenë e tillë: Pasuritë financiare me para të gatshme kanë qenë 256,5 milionë euro. Kur hiqet fondi i donatorëve, të hyrat vetjake, fondet në mirëbesim, të hyrat nga AKP-ja dhe fondet tjera në mirëbesim, fondet e pashpërndara më 31 dhjetor 2015 kanë qenë 201,1 milionë euro, që është 100% më shumë se sa që kemi pasur në dhjetor të vitit 2014. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti ministër!

Fjalën e ka Naser Osmani, kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa për arsyetimin e raportit me rekomandime.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues!

I nderuar ministër i Financave,

Të nderuar deputetë,

Raporti vjetor financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015, i dërguar nga Qeveria në Kuvend, është hartuar në pajtim me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit për sektorin publik, i bazuar në para të gatshme dhe është në pajtim me kërkesat ligjore të parapara me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë.

Raporti i pasqyron të dhënat për realizimin e të hyrave dhe shpenzimeve totale, krahasimin e tyre në planin buxhetor dhe vitin paraprak.

Po ashtu, raporti përmban të dhënat për llojin e të hyrave dhe shpenzimeve të realizuara, përfshirë të hyrat nga Doganat dhe Administrata Tatimore e Kosovës, të hyrat vetjake të komunave dhe të hyrat e nivelit qendror, grantet e pranuar nga donatorët, huazimet e jashtme dhe të brendshme dhe të hyrat sipas burimeve të caktuara. Po ashtu, raporti prezanton edhe nivelin e deficitit në raport me GDP.

Të hyrat gjithsej të realizuara për vitin 2015, duke mos përfshirë të hyrat nga grantet e përcaktuara të donatorëve dhe të hyrat nga fondi i depozitave, janë 1 690 349 000 euro dhe paraqesin 96% të të hyrave të planifikuara.

Krahasuar me vitin 2014, kemi një rritje prej 9,3% ose 241 mijë e 392 milionë euro, ku kryesisht kanë kontribuar të hyrat e rregullta financiare.

Sa i përket inkasimit të të hyrave nga Doganat janë realizuar 951 milionë e 808 mijë euro, apo 106% e të hyrave të planifikuara dhe paraqesin 9,3% më shumë në krahasim me vitin 2014. Në këto të hyra, përveç rritjes së importeve, ka ndikuar edhe ndryshimi i normës së akcizës për disa produkte dhe zbatimi i ligjeve të pakos së re fiskale. Nga Administrata Tatimore e Kosovës janë mbledhur 332 772 milionë euro apo 97,9% e planifikimit, ndërkaq krahasuar me vitin 2014 kemi një rritje prej 9,6%, gjë që ka ndikuar më shumë me fillimin e zbatimit të ligjeve të pakos fiskale, respektivisht përshkallëzimit të tatimit mbi vlerën e shtuar.

Të hyrat vetjake të komunave janë realizuar 57 880 000 euro apo 78% nga ajo që është planifikuar dhe kemi një ulje prej rreth 5% krahasuar me periudhën paraprake, ndërkaq të hyrat vetjake në nivelin qendror kanë shënuar rritje prej 12,8 milionë euro, apo 123,3% krahasuar me planifikimin vjetor.

Sa u përket huazimeve të jashtme, që janë pranuar, që kanë ardhur nga institucionet financiare ndërkombëtare, si nga Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, UNIT Kredi dhe KFV-ja janë realizuar në shumë prej 45,4 milionë euro, ndërsa huazimet e brendshme në emetimin e vlerave me vlerë janë realizuar në shumë prej 126,2 milionë euro.

Të hyra të tjera të rëndësishme për Buxhetin e Kosovës kanë qenë nga renta minerare prej 29,7 milionë euro apo 3,1 milionë euro më shumë se në vitin 2014.

Nga taksa koncesionare 6,5 milionë euro, nga licencat e liberalizimit të tregut të telefonisë mobile 23,1 milionë euro, nga gjjobat 49,1 milionë euro dhe nga dividendat e PTK-së 15 milionë euro.

Pagesat apo shpenzimet gjatë vitit 2015, duke mos përfshirë pagesat nga grantet e përcaktuara të donatorëve, dhe depozitat kanë qenë 1 597 983 000 euro dhe paraqesin 93% të shpenzimeve të përgjithshme vjetore të planifikuara dhe krahasuar me vitin 2014 kanë një rritje prej rreth 5,7%.

Shpenzimet sipas kategorive kryesore janë realizuar si në vijim:

- pagat dhe mëditjet janë realizuar mbi 524,9 milionë euro apo 94% e planit dhe paraqesin një rritje prej 7,4% krahasuar me vitin e kaluar, që përfshinë edhe implementimin e pagesës së përvojës së punës;

- mallrat dhe shërbimet janë realizuar 181,2 milionë euro apo 92% e planifikuar dhe paraqesin një rritje prej -2 krahasuar me vitin 2014;

- shpenzimet komunale janë realizuar 24,1 milionë euro apo 94% të planifikuarave;

- subvencionet dhe transferet janë realizuar 418 milionë euro apo 95% e krahasimit me planin dhe janë për 15,7% më të larta se viti paraprak;

- shpenzimet kapitale janë realizuar 403,8 milionë euro apo 84% krahasuar me planin;

- deficitin e përgjithshëm 1,3% e GDP-së apo 77 880 000, ndërkaq para të gatshme në fund të vitit 2015 janë 256 539 000 euro, që janë më të larta për 93 038 000 euro se sa në vitin 2014.

Kjo dëshmon se Qeveria ka arritur të paguajë të gjitha shpenzimet e parapara me Ligjin e Buxhetit 2015, njëkohësisht duke ruajtur stabilitetin buxhetor, gjë që tregon nivelin e deficitit buxhetor, që është nën kufirin e rregullës fiskale të përcaktuar me Ligj.

Komisioni për Buxhet dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 15.5.2016 pasi që ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015, vlerësoi se i njëjti ka përmbushur të gjitha obligimet ligjore për raportimin, që dalin nga Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe i ka rekomanduar Kuvendit, që njëkohësisht ju rekomandoj edhe sot në emër të kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa dhe në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, që të votoni raportin e shpenzimeve të Qeverisë për vitin 2015. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit deputet Osmani! Në emër të PDK-së, Safete Hadërgjonaj e ka fjalën.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

I nderuar ministër i financave,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar raportin financiar për vitin 2015. Sipas Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike raporti financiar i plotëson kushtet për tu shqyrtuar, sepse përmban tërë materien që është paraparë me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë për tu pasuruar përmes këtij raportimi.

Përmban të dhënat për të hyrat buxhetore, për shpenzimet buxhetore, si dhe të dhënat për rezervën shtetërore, ku vërehet se bilanci bankar i Qeverisë ka qenë më i lartë se në vitin paraprak për 93 381 000 euro, pra gjithsej 256 539 000 euro.

Raporti pasqyron të dhënat për deficitin buxhetor, ku shihet se viti 2015 është përmbyllur me deficit buxhetor 1,3% të GDP-së që është vlerë nën rregullën fiskale, që është 2% e GDP-së së

paraparë me Ligjin për menaxhimin e financave publike të Kosovës dhe janë të dhëna, të cilat duhet të vlerësohen.

Raporti do të ishte më i pasuruar dhe ne do të kishim mundësinë për të bërë një analizë më të mirë të të hyrave dhe shpenzimeve, sikur raporti të përfshinte edhe listën më të detajuar të të hyrave, sidomos të të hyrave komunale, si dhe listën e shpenzimeve kapitale. Sipas këtij raporti të hyrat janë rritur 17% krahasuar me vitin 2014, kurse realizimi i të hyrave krahasuar me ato të planifikuara është 97%. Në dukje, duket performansë e të hyrave sikur kjo performansë të ishte arritur në saje të menaxhimit më të mirë të financave publike dhe jo si pasojë e rritjes së tatimit mbi vlerën e shtuar dhe akcizës së duhanit, pijeve joalkoolike, ndryshimit të akcizës në makina, e të tjera...

Realizimi i të hyrave nga Doganat për 101% krahasuar me planifikimin është bërë pra, një rritje e konsideruar nga të hyrat në Doganë. Kjo rritje prej 9% krahasuar me vitin paraprak është për tu vlerësuar, sikur kjo rritje të ishte në saje të efikasitetit të politikave efektive fiskale, por nuk mund të pajtohem që kjo rritje e të hyrave të Buxhetit të ndikojë në rrënimin e bizneseve duke rritur TVSH-në e akcizën e produkteve të caktuara.

Rritja e të hyrave në Administratën Tatimore të Kosovës për 10% krahasuar me vitin 2014 është një sinjal i mirë, sikur këto të hyra të rriteshin jo për shkak të ngarkesave tatimore për bizneset dhe për qytetarët, po për shkak të rritjes së kapaciteteve të Administratës Tatimore të Kosovës për të menaxhuar më mirë ekonominë joformale, sikur kjo rritje të bëhej duke krijuar kushte për të operuar në sektorin formal të ekonomisë dhe jo nëpërmjet ndëshkimeve të tatimpaguesve, shpeshherë edhe të atyre që janë tatimpagues të rregullt.

Është shumë e rëndësishme që Qeveria të ketë një parashikueshmëri të ndryshimeve të politikave fiskale. Ndërrimi i shpejtë i këtyre politikave shpeshherë edhe ad hoc nuk jep rezultate politike dhe i shqetëson tatimpaguesit e rregullt. Në planifikimin buxhetor është paraparë që të hyrat komunale të rriten në 74 milionë euro bazuar në trendin e rritjes së të hyrave komunale në vitin 2014 dhe në vitin 2013, domethënë në vitin 2014 të hyrat kanë qenë 60 955 000 euro, kurse në vitin 2013 ato ishin 55 850 000 euro. Kurse, nëse e shohim tash raportin që na ka ardhur, shohim se të hyrat komunale janë zvogëluar për 16 360 000 euro, çka do të thotë se krahasuar me vitin paraprak ka një rënie prej 5% të të hyrave, që do të thotë se këto të hyra janë realizuar vetëm 78%.

Komunat tona sikur janë mësuar të marrin grante nga niveli qeveritar dhe pak i kushtojnë kujdes inkasimit të të hyrave vetjake, për çka është mirë të bëhet një analizë, se ku qëndrojnë problemet e mosrealizimit të të hyrave komunale.

A janë kanalizuar fondet për politika që janë shpallur si prioritet në programin e Qeverisë? Nëse analizojmë me kujdes shifrat e shpenzimeve, vërejmë se nuk janë arritur qëllimet që Qeveria ia ka vënë vetes si objektiva për t'i realizuar. Shëndetësia veç sa është keqësuar, nuk është arritur cilësia në arsim, ka rënie të nivelit të investimeve në infrastrukturë, kurse ka lëvizje pozitive në bujqësi.

Sipas këtij raporti ka një rritje të shpenzimeve për 103 481 000 euro, apo 7% krahasuar me vitin 2014. Pjesa më e madhe e shpenzimeve është bërë për paga dhe mëditje, ku shpenzimet në këtë kategori janë rritur 8% në krahasim me vitin 2014. Shpenzimet kapitale janë më të ulëta për 2% krahasuar me vitin paraprak. Subvencionet dhe transferet janë rritur për 16% dhe nëse shikojmë tabelën e shpenzimeve për subvencione dhe transfere, vërejmë se ende subvencionohen ndërmarrjet publike për 30 479 000 euro, kurse kemi vërejtur aty edhe një shpenzim, që ka qenë i pakuptueshëm për ne, prej 14 000 000 eurove për ristrukturimin e potencialit fizik, për të cilin ministri na dha sqarime dhe është mirë që edhe kur të pasqyrohen të dhënat, “ristrukturim i potencialit fizik” është i pakuptueshëm, për çka është mirë në fund të raportit të jepet një sqarim se për çka është fjala.

Në aneksin 9 është raporti i obligimeve të papaguara në nivel qendror dhe lokal, ku vërehet se ka rritje të dukshme të këtyre obligimeve krahasuar me vitin 2014. Ka rritje të këtyre obligimeve për 34 883 000 euro, kurse krahasuar me vitin 2013 ka rritje për 150 966 000 euro. Rritja e këtyre obligimeve shkon në dëm të bizneseve dhe në dëm të qytetarëve të Kosovës.

Në aneksin 12 shohim se 21 komunë e ka shkelur Ligjin për Buxhetin, kur është paraparë numri i mundshëm i të punësuarve, duke shtuar numrin e të punësuarve mbi numrin e të planifikuarve dhe kjo ka ndodhë në 21 komuna, të cilat e kanë pasur buxhetin e saktësuar se deri ku mund të shkojnë me numrin e të punësuarve.

Nëse duam të jem vend kandidat për në Bashkimin Evropian dhe të kemi qasje në institucionet financiare ndërkombëtare, nëse duam mirëqenien e qytetarëve, ne duhet ta përmirësojmë strukturën e shpenzimeve buxhetore.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës përkrahë rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për miratimin e raportit financiar për vitin 2015. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja Hadërgjonaj! Fjalën e ka Salihe Mustafa.

SALIHE MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë,

Raporti i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2015 që sot po e diskutojmë është një raport i përgjithësuar, por unë do të ndalem te Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ku thuhet që 8 OJQ-të strehimore që ofrojnë shërbime për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje janë mbështetur me 350 000 euro për vitin 2015.

Të nderuar kolegë, në disa takime dhe tryeza të mbajtura me udhëheqëset e këtyre strehimoreve kemi ankesa se gjendja është alarmante dhe se këto strehimore rrezikojnë të mbyllen. Unë pajtohem, se këto strehimore duhet të mbështeten nga Qeveria dhe nga komunat, por do të ishte mirë që në këtë raport apo thotë këtu, ministri të na e sqarojë, se kjo shumë e mjeteve si është ndarë?! A ka kritere për ndarjen e këtyre mjeteve? A ndahen në bazë të projekteve dhe a trajtohen njësoj këto strehimore?

Gjithashtu, në raport të Qeverisë, gjegjësisht të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale konstatohet që grupi punues për ripërtëritjen e marrëveshjeve sipas konventave ndërkombëtare të

sigurimit pensional invalidor, ka zhvilluar negociata të vazhdueshme me Qeverinë e Zvicrës, Shqipërisë, Maqedonisë, me të cilat janë diskutuar çështjet dhe problemet lidhur me zbatimin e marrëveshjeve.

Ne si deputetë duhet të dimë se cilat janë rezultatet e këtyre negociatave, pse nuk po nënshkruhen marrëveshje dhe a i kemi mbushur kriteret si shtet për nënshkrimin e këtyre marrëveshjeve, në mënyrë që qytetarët tanë të mos pësojnë më? Mandej, te Ministria e Shëndetësisë thuhet se odat e profesionistëve shëndetësor janë në themelime sipër, çka pajtohem që gjatë vitit 2015 janë themeluar, por ne duhet të dimë se a janë funksionalizuar ato?! Gjithashtu, nuk kemi raport të detajuar për Agjencinë Financiare të Shëndetësisë si paraardhës i fondit të sigurimeve shëndetësore. Do të ishte mirë të dimë kur do të fillojë mbledhja e premiumeve.

Tek imunizimi, sipas këtij raporti thuhet se imunizimi i fëmijëve të komunitetit rom vazhdon dhe se janë vaksinuar 550 fëmijë. Ne e dimë se gjendja e vaksinimit (imunizimit) në Republikën e Kosovës është në gjendje shumë të mirë dhe do të ishte mirë, që fëmijët e këtij komuniteti të vaksinohen të gjithë, sepse i dimë pasojat e mosvaksinimit të një pjese të fëmijëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Nuk kemi të tjerë të paraqitur për këtë pikë të rendit të ditës. Presim deputetët!

Vazhdojmë me pikën e gjashtëmbëdhjetë:

16. Shqyrtimi i raportit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2015

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar raportin e punës së Agjencisë Shtetërore për mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2015 dhe Kuvendit is ka rekomanduar për miratim.

Gjithashtu edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin financiar të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim. Edhe një herë theksoj, e bëra inversionin e pikës me qëllim që ta kemi këtu ministrin, në mënyrë që diskutimi të bëhet substancial në mes Qeverisë e Kuvendit. Kjo është arsyeja.

Tani ju lutem, fjalën e ka Fadil Demaku, nënkryetar i Komisionit Funkcional për arsyetimin e raportit me rekomandime. Urdhëroni, zoti Demaku.

FADIL DEMAKU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar deputetë,

Ministër,

Komisioni Parlamentar për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës në bazë të nenit 72 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores së Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 20. 4.2016 shqyrtoi raportin vjetor të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2015 dhe vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë rekomandim:

- Të miratohet raporti vjetor i punës së Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2015.

Dua të shtoj se në komision gjatë shqyrtimit të këtij raporti të agjencisë është kërkuar nga anëtarët e komisionit fuqizim shumë më i madh i punës së Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale duke pasur parasysh rëndësinë e të dhënave personale, mbrojtjen e të dhënave personale në një shoqëri me një zhvillim të jashtëzakonshëm dhe me dinamikë të jashtëzakonshme dhe avancim të teknologjisë. Kështu që, edhe vendi ynë do të punojë jashtëzakonisht shumë për mbrojtjen e të drejtave dhe të mbrojtje të dhënave personale të çdo individi në shoqërinë tonë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet Demaku! Fjalën e merr zoti Osmani... nuk e do fjalën. Atëherë, në emër të grupeve parlamentare, Ganimete Musliu në emër të Grupit të PDK-së.

GANIMETE MUSLIU: Faleminderit, zoti kryesues!

Njëherësh të falënderoj edhe një herë që morët mundin dhe shpjeguat arsyeshmërinë e lëvizjes nga një pikë e rendit të ditës. Nuk kemi asgjë kundër që të jemi sa më efikas në punë dhe të respektojmë angazhimin e madh të ministrave që kanë, por megjithatë mendoj që është e rrugës që të vihet në votim kur shmangemi nga rendi i ditës, qoftë edhe një votim formal për të respektuar deprimin e deputetëve që janë në sallën e Kuvendit.

Këtë desha ta them paraprakisht, për të vazhduar pastaj me opinionin, ose thjesht me mendimin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës lidhur me raportin e Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, ku Partia Demokratike e Kosovës e vlerëson dhe e përkrahë këtë raport gjithmonë duke e vlerësuar lartë punën e kësaj agjencie në vitin 2015 dhe duke pasur parasysh dhe duke qenë të vetëdijshëm që puna e kësaj agjencie varet edhe nga një varg institucionesh tjera, siç është sistemi i drejtësisë, Policia e Kosovës, regjistrimi civil e kështu me radhë... atëherë, vlerësojmë dhe kërkojmë që duhet të zbatohen ligjet që janë në fuqi dhe të mos neglizhohen rastet dhe çështjet që ngritën nga kjo agjenci.

Ne e dimë shumë mirë që kjo agjenci është themeluar shumë vonë në shtetin e Kosovës, por megjithatë punët elementare dhe ato që nuk duan shumë sakrificë duhet të kryhen dhe të mos neglizhohen. E kemi rastin, për shembull, me KEDS-in, e kemi rastin me Ujësjiellësin dhe institucionet tjera, të cilat faturojnë qytetarët e Kosovës, ku në adresat tona vijnë fatura të pazarfuara, ku të dhënave personale si qytetarë ekspozohen ndaj çdo rreziku të mundshëm. Prandaj, kërkoj që këto institucione t'i marrin me përgjegjësi të plotë dhe thjesht të veprojnë në kuadër të rekomandimeve, që ju jep kjo agjenci.

Si komision i kemi dhënë vërejtjet tona, do t'i japim edhe si grup parlamentar dhe presim që rekomandimet, të cilat ne i kemi propozuar kësaj agjencie, institucionet, të cilat unë vetëm i përmenda në fjalimin tim, thjesht të merren parasysh në institucionet gjegjëse. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete Musliu! Nuredin Ibishi e ka fjalën.

NUREDIN IBISHI: I nderuar kryesues,
Të nderuar deputetë dhe deputete,

Përfaqësues të medie dhe qytetarë,

Grupi Parlamentar i LDK-së ka shqyrtuar raportin vjetor të punës të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave. Gjithashtu, në mes dy deputetëve që janë anëtarë të komisionit kanë dhënë kontributin e vet dhe vlerësojmë dhe çojmë punën e kësaj agjencie, sidomos në përmbushjen e mandatit me krejt fushatën në vetëdijesimin e qytetarëve, por edhe në detyrat tjera, për të cilat i ka të përcaktuara edhe në mandat edhe në kompetencat funksionale.

Duhet dhënë përkrahje edhe në vitet e ardhshme, sidomos në vitin që jemi, pra 2016, sidomos më 2017, në vitin edhe të kapaciteteve njerëzore edhe për shkak të nevojës në personel, por edhe në ato financiare, për shkak se agjencia ka nevojë edhe në aspektin financiar të mbështetjet, nga se një kohë është bazuar edhe në donacionet nga institucionet e ndryshme ndërkombëtare të pranishme në Kosovë.

Duhet vlerësuar shumë edhe aspektin e integritimit apo të anëtarësimit në shoqatat por edhe forumet rajonale, evropiane por edhe ndërkombëtare të kësaj agjencie, edhe që duhet vlerësuar gjithashtu që ajo ka përmbushë plotësisht projektet e IPA-s në periudhën e kaluar. Pra, me këtë edhe Grupi Parlamentar i jep përkrahje raportit edhe vlerëson si një raport të qëlluar edhe në aspektin formal, po edhe në aspektin substancial.

KRYESUESI: Faleminderit! Të tjerë nuk ka. Unë megjithatë po ndiej nevojë për një shpjegim plotësues, zonjës Ganimete, rreth vërejtjes.

Jam ihtar i korrektësisë të çdo rregulli. Veç sa për shpjegim, në momentin kur drejtuesi e drejton, ai është interpretuesi momental i rregullores, edhe i detyruar do të thosha, sepse s'kisha qysh ju konsultoj juve, se pa qenë 61 s'ka konsultim. Kaq!

Tutje... shkojmë, duke pritur deputetët, në pikën e tetëmbëdhjetë:

18. Shqyrtimi i raportit të punës së Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2015

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar raportin e punës së Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim me rekomandimet e propozuara.

Gjithashtu edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa ka shqyrtuar raportin financiar të Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2015 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim.

Muhamet Mustafa kryetari Komisionit Funkcional e ka fjalën për arsyetim të raportit me rekomandime. Muhamet Mustafa e ka fjalën.

MUHAMET MUSTAFA: I nderuar kryesues,

Të nderuar kolegë deputetë,

Shkurtimisht, lidhur me rekomandimet. Pra, kemi katër rekomandime. I pari ka të bëjë me nevojën që Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministria e Planifikimit Hapësinor bashkë me Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale të bëjnë harmonizimin e ligjeve, të cilat ata i

zbatojnë në punën e tyre të përditshme, të cilat kanë disa shpërputhje që shprehen keq dhe negativisht në punën e këtij komisioni.

Ne kemi kërkuar që kjo të bëhet sa më shpejt dhe menjëherë në vijim rekomandimi tjetër është që Komisioni i Pavarur për Miniera e Minerale duhet ta informojë Komisionin Funkcional në Kuvend lidhur me ecurinë e harmonizimit, sepse ky problem po zgjatë ka dy tri vjet.

Rekomandimi tjetër ka të bëjë me nevojën që të thellohen disa rezultate financiare, që janë arritur më 2015, sa i përket pengimit të operatorëve ilegalë dhe gjithashtu, nevojitet një punë më e madhe në inkasimin e borxheve. Kemi kërkuar që në raportet e ardhshme të jetë një nivel më i madh i analizës e jo raporti të dominohet vetëm me përshkrim. Gjithashtu, një nga rrethanat pozitive është se kemi një rritje të mirë të rentës minerare apo “royalties” (tantiemës).

Komisioni ju fton që ta aprovoni këtë raport.

KRYESUESI: Faleminderit! Naser Osmani e ka fjalën, është kryetar i Komisionit për Buxhet dhe Financa.

NASER OSMANI: Faleminderit, kryesues!

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale ka dorëzuar në Kuvend raportin vjetor financiar për vitin 2015. Sipas të dhënave të kërkuara raporti pasqyron të dhënat për buxhetin e miratuar, ndryshimet që kanë ndodhur gjatë vitit, si dhe të dhënat për shpenzimin e buxhetit sipas kategorive dhe nënkategorive ekonomike dhe krahasimet me vitin paraprak.

Buxheti i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2015 ka qenë 1 275 817 euro, ndërsa pas rishikimit dhe ndryshimeve që janë bërë si rezultat i vendimeve të Qeverisë, buxheti përfundimtar ka qenë 1 186 273 euro. Nga kjo shumë janë shpenzuar 1 129 638 euro apo 95,2%.

Buxheti i shpenzuar sipas kategorive ka qenë për paga dhe mëditje 100%; mallra dhe shërbime 86,1%; shpenzime komunale 89,1%; subvencione dhe transfero 100% dhe shpenzime kapitale 99,3%.

Duke pasur parasysh që raporti ka përmbajtur të gjitha elementet e duhura për raportim financiar, komisioni e ka vlerësuar dhe ai i ka rekomanduar Kuvendit që ta votojë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetari Kuvendit!

Përsëritje kolegë deputetë!

Ka qenë mirë që gjatë shqyrtimit të këtij raporti të jetë edhe ndonjëri nga qeveritarët tanë këtu, sepse është një institucion shumë i rëndësishëm Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale. Unë do të bëj përpjekje që shumë shkurt, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, t'i them disa fjalë në lidhje me këtë raport.

Ky raport prezanton në mënyrë përmbledhëse punën e realizuar gjatë vitit 2015. Raporti i punës përmban punën dhe aktivitetet e bëra në fushën e gjeologjisë, përkatësisht hulumtimit, xehetarisë

shfrytëzimit, përpunimit, rezultatet e arritura gjatë vitit, problemet dhe sfidat, me të cilat është ballafaquar ky rregullator gjatë punës së vet, si dhe objektivat e parapara për të ardhmen.

Sipas këtij raporti, viti 2015 ka qenë një vit sfidues dhe i vështirë për industrinë minerare në botë për shkak të rënies së çmimeve të metaleve në tregjet botërore.

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale, edhe përkundër kësaj, ka arritur rezultate pozitive me tejkalim të buxhetit për 11% në krahasim me vitin 2014.

Sipas këtij raporti, kontribuuesit më të mëdhenj në mbushjen e buxhetit janë KEK-u, “Ferronikeli”, “Sharr-Cemi” dhe guroret të cilat nxjerrin dhe përpunojnë shkëmbinj të fortë. Brenda vitit 2015 janë lëshuar 163 licenca dhe leje.

Në raport janë paraqitur edhe sfidat për të ardhmen duke marrë parasysh të drejtat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me Ligjin për miniera dhe minerale, rregullat tjera në përgjithësi në njërën anë dhe ndërmarrjen e aktiviteteve për zbatimin e tyre në praktikë në anën tjetër si sfida për arritjen e objektivave të parapara në të ardhmen veçohen operimet ilegale të cilat po ndikojnë në degradimin e ambientit, dëmtimi i konkurrencës për operatorët e licencuar ose legalë, në shqiptimin e një numri të madh gjobash si dhe rritjet e borxheve ndaj Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale, mosaprovimi formal i planit të veprimit për parandalimin dhe ndalimin e operuesve ilegalë nga Qeveria, apo institucioneve përkatëse.

Sfidë tjetër është mosharmonizimi i kornizës organizative dhe ligjore në sektorin minerar në veçanti me Ligjin për pyjet e Kosovës, pamundësia e implementimit të dispozitave ligjore për sekuestrim të mjeteve të makinerisë me rastet e veprimeve ilegale, menaxhim i cili synon sigurimin e resurseve minerale për gjeneratat e tashme dhe ruajtjen e qasjes në resurset natyrore edhe për gjeneratat e ardhshme në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Rritja e numrit të lëndëve ose rasteve nëpër gjykata, shqiptimi i një numri të madh gjobash, si dhe rritja e borxheve ndaj KPMM-së.

Borxhlinjtë ndaj KPMM-së janë Trepça, Artana, Stan-Tërg, Belloberdë e Cërnac që nuk i kanë kryer obligimet financiare ndaj këtij institucioni. Detyrimet e këtyre minierave ndaj KPMM-së për vitin 2015 janë mbi 700 000 euro.

Çështja e përmbarrimit të ekzekutimit të gjobave administrative dhe vendimeve në përgjithësi ndaj KPMM-së.

Sfidë tjetër që është shumë me rëndësi është mungesa e një objekti të përhershëm për zyrë, Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale është i obliguar që të marrë me qira objekt privat me një hapësirë prej 1 300 metra katrorë i cili përveç shpenzimeve të mëdha të qirasë nuk i përmbush as kushtet, si për nga hapësira, e po ashtu edhe nga funksionaliteti.

Vështirësitë tjera me të cilat ky institucion është ballafaquar në vitin 2015 është, siç u përmend më lartë, edhe mosharmonizimi i ligjeve tjera me ligjin e minierave, gjatë punës së përditshme, zbatimin e dispozitave ligjore, ky institucion ka hasur në vështirësi rreth sigurimeve dhe

garancive që Ligji i minierave i ka paraparë për ndërmarrjet e licencuara, kurse më vonë kjo çështje është rregulluar edhe me akte tjera të brendshme me udhëzim administrativ.

Punën dhe aktivitetin e këtij institucioni gjatë vitit 2015 e kanë përcjellë një mori vështirësish, të cilat në raste të caktuara kanë ndikuar në uljen e efikasitetit të punës së këtij institucioni mjaft të rëndësishëm për ekonominë e Kosovës. Mungesa e kuorumit të Bordit për vendimmarrje që nga prilli i vitit 2014, për një vit e më shumë moskompletimi i këtij bordi, ka ndikuar në mosrealizimin e detyrave që janë të parapara me ligj.

Mbledhja e borxheve të vjetra nga Komisioni i Pavarur për Miniera e minerale nuk është përfshirë në Ligjin për faljen e borxheve. Vlen të theksohet se gjatë vitit 2010-2015 për hapësirë për zyrë me qira KPMM ka shpenzuar nga buxheti i Kosovës shumën prej afërsisht 500 000 që do të thotë se një amendament i paraqitur në projektligjin e buxhetit të vitit 2016 nuk ka kaluar ky Kuvend për të cilin do të kursente shumë edhe buxheti dhe do të bëhej më funksional ky institucion.

Krejt në fund, ju ftoj ta votoni këtë raport dhe shpresoj që Qeveria do ta shtojë vëmendjen ndaj sektorit minerar si një shtyllë garantuese për zhvillim ekonomik. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Duke pritur deputetët për votim, kalojmë në pikën e nëntëmbëdhjetë:

19. Shqyrtimi i raportit të punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2015

Komisioni Funksional e ka shqyrtuar raportin e punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Edhe Komisioni për Buxhet e Financa e ka shqyrtuar raportin financiar të Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Fjalën e ka Selviqe Halimi, nënkryetare e Komisionit Funksional, për ta arsyetuar raportin me rekomandime.

Edhe një herë Armend Zemaj, në emër të Komisionit. Urdhëro, Armend!

ARMEND ZEMAJ: Në mungesë të Albulenës, Selvisë, të Danushit radha në emër të Komisionit është te unë. Faleminderit!

Kolegë deputetë,

Komisioni për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit në cilësi të Komisionit Funksional dhe duke u bazuar në nenin 72 të Rregullores së Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur me 26. 4. 2016, e shqyrtoi raportin e punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2015.

Raporti para Komisionit është paraqitur nga drejtori Hasan Preteni, i cili e njoftoi Komisionin me të arriturat dhe sfidat që i ka ky institucion, duke përmendur risitë në legjislacion, veçmas atij

penal, pasi që tani mos deklarimi i pasurisë është vepër dhe agjencia obligohet që të ushtrojë autoritetin e tij ligjor që këto raste të procedohen në institucionet e drejtësisë.

Në vitin 2015, nga agjencia janë ushtruar 126 kallëzime penale kundër 189 zyrtarëve publikë. Në këtë kontekst janë paraqitur të dhëna statistikore në këto vite 2007-2015 që përbëjnë raste të përcjella në organe kompetente të drejtësisë.

Rreth deklarimit të pasurisë, u tha se këtë vit 95,5% e zyrtarëve të lartë e kanë deklaruar pasurinë dhe autoriteti i agjencisë është mbuluar në tërë territorin vendit. Më tutje u theksua se është e nevojshme ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në këtë rrafsh pasi që do të duhej të kishte kufizime që zyrtarët e lartë të mos mbajnë disa funksione publike.

Edhe më tutje, problemi kryesor mbetet prokurimi publik i cili paraqet një rrezik të fuqishëm sa i përket korrupsionit ku përfshihet mosrespektimi i ligjit në të gjitha fazat nga përgatitja, publikimi, vlerësimi, lidhja e kontratës dhe zbatimi.

Komisioni funksional i ka dhënë përkrahje raportit dhe po ashtu fton edhe deputetët që ta votojnë këtë raport vjetor për vitin 2015. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Për PDK-në, fjalën e ka deputeti Agim Aliu.

AGIM ALIU: Faleminderit, zoti nënkryetar!

I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar dhe analizuar raportin vjetor të vitit 2015 të Agjencisë Kundër Korrupsionit dhe e vlerëson pjesën e mirë të punës që është bërë, edhe pse lufta kundër korrupsionit dhe dukurive të lidhura me të vazhdon të mbetet sfidë, punë dhe angazhim i përhershëm i të gjitha institucioneve tona si dhe shoqërisë në përgjithësi, në mënyrë që të sigurojmë një të ardhme me perspektivë të sigurt për qytetarët dhe për Republikën në rrugën drejt integriteteve euroatlantike dhe krahas me shtetet e zhvilluara në aspektin ekonomik, politik e demokratik.

Besojmë se duhet miratuar një raport i tillë, edhe pse, duke e krahasuar me raportin e një viti më parë, nuk paraqet ndonjë të arritur të veçantë për faktin se ende nuk kemi pjesë të këtij raporti ku paraqiten të arriturat e tilla të cilat, sadopak, do të ishin shpresë më e madhe për ulje të korrupsionit dhe perceptimit për të.

Raportin e agjencisë vazhdon ta dominojë numri më i madh i rasteve të reja nga mosdeklarimi e pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, kjo edhe si pasojë e Kodit të ri Penal, të hyrë në fuqi nga viti 2013, që parasheh si vepër penale mosdeklarimin e pasurisë dhe deklarimin jo të saktë.

Kjo konsideroj se nuk është pista reale, respektivisht qasja e duhur në luftë kundër korrupsionit sepse ajo pasuri respektivisht të hyrat nga pagat buxhetore të zyrtarëve janë publike dhe të qasshme në çdo moment nga organet e ndjekjes, por përkundrazi ashtu sikur që e kemin ngritur si shqetësim në raportimin para Komisionit është edhe një lloj zhvendosjeje nga pistat e vërteta

të luftës kundër korrupsionit sepse me muaj të tërë opinioni përqendrohet vetëm në këtë çështje dhe mbetet një temë populiste, por jo lufta e vërtetë kundër korrupsionit.

Si edhe në raportin e vitit të kaluar, edhe në këtë vit, pjesë e raportit janë të gjitha rastet që nga themelimi i agjencisë e deri me tash dhe në gjithë këtë raportim kemi një numër të vogël të ngritjes së akuzave nga organet e ndjekjes.

Që nga viti 2007 e deri me 2015 kemi vetëm 50 raste me vendime gjyqësore dhe atë shumica siç e theksuam më lartë, për mosdeklarim apo deklarim jo të saktë të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë.

Shumica e rasteve të hedhura poshtë nga organet kompetente të drejtësisë se rastet e tilla nuk paraqesin vepra penale, por shkeljet e ndryshme administrative e vënë në pikëpyetje kapacitetin dhe profesionalizimin edhe brenda agjencisë, prandaj konsiderojmë se duhet fuqizuar puna dhe kapacitetet e agjencisë.

Vlerësojmë punën e bërë në parandalimin e korrupsionit në aktivitetet e ndryshme të prokurimit publik në gjithsej 112 raste gjatë vitit 2015, por do të duhej edhe më shumë punë dhe angazhim në këtë fushë nga agjencia.

Një ndër vështirësitë që i ka pasur agjencia në kuadër të përmbushjes së mandatit të saj, ka qenë edhe mosmiratimi i plotësimit dhe ndryshimit të Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit e që kjo nuk ka ndodhur për fajin e saj, por për shkakun se përkundër faktit që puna e këtij legjislacioni është përballur me vështirësitë tashmë të njohura për të gjithë ne, Komisioni brenda një kohe të shkurtër dy herë e ka amendamentuar Projektligjin në fjalë dhe ka qenë të dyja here në rend dite në seanca plenare të Kuvendit, por fatkeqësisht dhe për arsyeja të panjohura e të pa kuptueshme është tërhequr të dyja hera në momentin e fundit nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Besojmë se më në fund do të kemi vullnetin real dhe seriozitetin e duhur të Qeverisë për të sjell në Kuvend këtë projektligj në mënyrë që të miratohet dhe që sado pak të paraqet një argument të shtuar se jemi më të përgjegjshëm në luftën kundër korrupsionit.

Tashmë është i njohur fakti se miratimi i një projektligji të tillë do të parandalonte konfliktin e interesit në 1 552 raste dhe kjo tregon domosdoshmërinë e miratimit të këtij ligji.

Duke vlerësuar edhe një herë raportin e paraqitur të agjencisë dhe duke shprehur besimin se të gjithë ne do të shtojmë angazhimet dhe përgjegjësitë tona në luftimin e korrupsionit dhe dukurive të lidhura me të, në mënyrë që t'i hapet më shumë rrugë zhvillimit ekonomik, investimeve të huaja dhe uljes së papunësisë të të rinjve tanë, kërkoj nga ju të nderuar deputetë të Kuvendit që ta miratoni raportin e Agjencisë. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit zoti deputet Aliu! Fjalën e ka deputeti Agim Ademaj.

AGIM ADEMAJ: Faleminderit nënkryetar!
Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i LDK-së e ka shqyrtuar raportin e punës së Agjencisë Kundër Korrupsion për vitin 2015 dhe i njëjti i plotëson kriteret raportuese dhe është i kompletuar me të dhëna që paraqesin punën dhe sfidën e kësaj agjencie.

Ajo çka shihet nga raporti i agjencisë, si shqetësuese në vazhdimësi është çështja e korrupsionit në fushën e prokurimit publik dhe përgatitja jo e mjaftueshme apo thënë më mirë mosnjohja e nevojshme e ligjit të prokurimit nga stafi kompetent për ndjekjen e atyre që shkelin dispozitat ligjore të kësaj sfere, andaj rekomandohet trajnim i posaçëm për këtë pjesë të stafit. Për shembull, Departamenti i Krimeve Ekonomike, Policia, stafi i prokurorive, e tjera.

Raporti na sugjeron që të merremi me ndryshimin e ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit si masë preventive për zvogëlimin e mundësisë së ardhjes deri te korrupsioni, sidomos pamundësia e mbajtjes së disa vendeve të punës nga zyrtarët e lartë.

Problem në vete mbetet vërtetësia e prejardhjes së pasurisë dhe mendoj se kjo është sfidë dhe është koha e fundit që kjo çështje të merret në trajtim.

Ne ftojmë që ky raport të aprovohet por duhet sqaruar se aq sa i kemi dhënë kompetenca kësaj agjencie me ligj ato edhe në njëfarë forme i ka përmbushur. Më tepër nuk ka mund të bëjë për këtë sferë, e që ne e kemi bregë të vazhdueshme luftimin e korrupsionit.

Edhe një herë i ftoj kolegët që ta votojnë këtë raport. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Duke pritur deputetët për të votuar, kalojmë në pikën e fundit të rendit të ditës, që është:

20. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2015

Komisioni Funkcional e ka shqyrtuar raportin e punës së Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim me rekomandimet e propozuara.

Gjithashtu edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar raportin vjetor financiar të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2015 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Fjalën e ka deputeti Muhamet Mustafa, kryetar i Komisionit Funkcional, për ta arsyetuar raportin dhe rekomandimet.

MUHAMET MUSTAFA: Faleminderit!

Komisioni e ka shqyrtuar këtë raport dhe ka konstatuar se raporti është mjaft cilësor dhe i përmbush të gjitha kushtet e parapara me ligjin përkatës dhe Rregulloren e Kuvendit, andaj i ka rekomanduar që të miratohet raporti me dy rekomandime.

Rekomandimi i parë ka të bëjë që kjo agjenci, bashkërisht me Ministrinë përkatëse të Infrastrukturës, t'i ndërmarë të gjitha masat që të bëhet e mundur shfrytëzimi i korridoreve të ulëta ajrore në mënyrë që të rritet mundësia për më shumë fluturime dhe të rritet niveli i konkurrencës me Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës.

Gjithashtu, rekomandohet që kjo agjenci ta rrisë konkurrencën me më shumë operatorë nëpërmjet të realizimit të funksioneve që i ka. Të dy këto rekomandime duhet të ndikojnë në uljen e çmimeve të biletave nga Aeroporti i Prishtinës sidomos në sezonin e pushimeve verore dhe dimërore kur shumë punëtorë tanë apo qytetarë të Kosovës që jetojnë në Evropën Perëndimore e vizitojnë Kosovën që në ato periudha biletat shtrenjtohen mjaft. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Sala Berisha-Shala.

SALA BERISHA-SHALA: Faleminderit, nënkryetar!

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Raportin e punës së Autoritetit të Aviacionit Civil dhe e mbështet në parim dhe më lejoni të theksoj se është njëri ndër raportet më të mira të cilët i vijnë Kuvendit që i përgjigjen Kuvendit të Republikës së Kosovës. Ju ftoj ta mbështetni!

KRYESUESI: Faleminderit! Kolegë të nderuar, deri tash i kemi diskutuar të gjitha pikat e rendit të ditës. Unë ju kisha lutur të merremi vesh se si do të vazhdojmë punën.

Ju lutem, ma jepni listën të dimë sa deputetë janë të pranishëm.

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Unë, nën një, duhet të ju informoj se kartela nëpër aparate deri më tash janë 75, e tash janë 73, mirëpo në sallë deputetë janë 57, e kjo i bie që ne nuk mund të votojmë, prandaj vazhdojmë diskutimin. Kjo ishte nën një.

Nën dy, çfarëdo vendimi nuk mund të marrim me 57 deputetë sot, prandaj unë kaloj në nivelin tjetër të konsultimit. Lus shefat e grupeve parlamentare që janë të pranishëm, dhe nuk e di a janë të gjithë, por po shoh disa janë këtu, le të artikulohej - a duan dhe kur duan ta vazhdojmë këtë mbledhje sot? A i sjellin 61 deputetë këtu? Pra, jua jep fjalën me rend secilit.

Përndryshe, unë nuk mund të vendos asgjë tash dhe kërkoj prononcimet tuaja. Dhe, para kësaj, ju lutem, theksoj se në sallë janë të pranishëm 57 deputetë dhe lus regjinë le të regjistrohet kush është këtu tash.

Të pranishëm për momentin janë 56, e kush është ai i 57-ti, ose ka dalë në ndërkohë, nuk e di, por ne listën e kemi, e kush është ai le të paraqitet, s'ka problem.

Pra, 56 deputetë janë të regjistruar që janë këtu. Faleminderit! Lus listën të ma sjellë regjia.

Atëherë, ju lutem, zoti Grabovci e ka fjalën.

ADEM GRABOVCI: Faleminderit, zoti nënkryetar!

Sinqerisht, unë dua së pari të shpreh keqardhjen time dhe më vjen keq për kolegët e nderuar deputetë të cilët nuk janë të vetëdijshëm për përgjegjësinë që e kanë. Ne kemi tri javë që nuk kemi pasur seancë dhe e kemi obligim e përgjegjësi që të marrim pjesë dhe të mundësojmë funksionimin normal të Parlamentit të Kosovës.

Megjithatë, unë mendoj se duhet të bëjmë një zgjidhje, sepse me Rregulloren që e ka Kuvendi u mundëson deputetëve që të sillen në këtë mënyrë. Prandaj, ne duhet në të ardhmen të gjejmë një formë që deputetët të cilët nuk marrin pjesë në votim mos të kenë të drejtë të marrin mëditjet.

Pra, duke e pasur parasysh këtë situatë, unë mendoj që duhet ta lëmë votimin për javën e ardhshme, apo për një seancë të re, kur do ta caktojë Kryesia.

KRYESUESI: Zoti Ismet Beqiri e ka fjalën.

ISMET BEQIRI: Faleminderit nënkryetar!

Sa i përket asaj se ku është niveli i përgjegjësisë ose i papërgjegjshmërisë të disave, është e tepërt të flasim dhe vërtet, në të ardhmen, pa dashur të bëja as panik, e as të madhe, por sinqerisht është e pakuptueshme. Nuk ka rëndësi se çfarë shkruan në dokumente apo ligjore, se deputetit i jepet mundësia dhe e ka njëfarë pavarësie me qenë apo mos të qenë, por vërtet mospjesëmarrja është papërgjegjësi totale dhe le të më kuptojnë drejt deputetët që janë këtu, disa që nuk janë e disa që vijnë, hyjnë e dalin, por sidoqoftë për këtë është çështje që do ta bisedojmë në të ardhmen edhe në grupet tona parlamentare.

Pra, pa dashur të zgjas, meqë kanë mbetur vetëm votimet, ne mund ta bëjmë këtë në një seancë javën e ardhshme, pra në fillim të një seance tjetër, të vazhdojmë e t'i votojmë këto pika, sepse mos të gabohem, janë 4 pika.

(Ndërrhyrje)

OK, numri s'çon edhe shumë peshë, janë 4 a 5. Pra, mund të votojmë edhe javën tjetër, mund të provojmë edhe për pasdite, por nuk di si. Prandaj, po e lëmë që ne e mbështetim atë që në seancën e radhës t'i votojmë pikat që kanë mbetur vetëm sa për t'i votuar. Faleminderit!

KRYESUESI: Mufera Shinik, në emër të Grupit "6+" e ka fjalën.

MUFERA SHINIK: Faleminderit, kryesues!

Plotësisht pajtohem me propozimin e shefit të Grupit të PDK-së, Adem Grabovci. Faleminderit!

KRYESUESI: Për Listën serbe Simiq, apo ai që e zëvendëson Simiqin? Lista serbe? Sërgjan Popoviq, a është?

SRĐAN POPOVIĆ: I mi se slažemo isto da ova sednica, ako nemamo dovoljan broj poslanika, da se nastavi na sledećoj sesiji. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! Atëherë, grupet parlamentare do të thotë nuk janë të zotët ta japin premtimin për të caktuar sot një kohë kur do të bëhemi shumica për të votuar. A po i bie kështu? Se ne mund ta caktojmë, dhe një orë e kemi për të votuar, por ju thoni se sot s'mund të vazhdojmë.

Atëherë, sugjerimi i kryetarëve të grupeve parlamentare është që seanca me votimin për pikat e rendit të ditës që kaluam sot të nisë para seancës së ardhshme. Mirupafshim dhe faleminderit!

E mërkurë, 25 maj 2016

Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 18 maj

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Kadri Veseli.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra të Kabinetit qeveritar,
Vazhdojmë me punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, të filluar më 18 maj 2016.

Në sallë janë të pranishëm 64 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për punë.

Vazhdojmë me pikat, si në vijim:

4. Shqyrtimi i Projektligjit për ratifikimin e Konventës për heqjen e kërkesës për legalizim të dokumenteve zyrtare të huaja (5 tetor 1961)

Komisioni për Punë të Jashtme e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Ftohet ministri në detyrë, zoti Petrit Selimi, që ta paraqesë dhe arsyetojë projektligjin. Atëherë, pasi nuk është i pranishëm ushtruesi i detyrës ministrit, e kalojmë këtë pikë të rendit të ditës

Të nderuar deputetë,

Diskutimet për këtë pikë, si dhe për pikat në vazhdim, 16, 17, 18, 19 dhe 20 kanë përfunduar në seancën plenare, të mbajtur më 18 maj 2016, ndërsa për mungesë të kuorumit nuk janë proceduar për votim. Andaj, në seancën e sotme do të procedojmë vetëm me votimin e tyre.

15. Votimi i raportit të Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2015

Lus regjinë dhe deputetët të përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 63 vota për, një abstenim dhe asnjë kundër, Kuvendi e miratoi raportin e Punës së Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2015.

16. Votimi i raportit të Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2015

Lus regjinë dhe deputetët të përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 59 vota për, 3 abstenime dhe 2 kundër, Kuvendi e miratoi raportin e Punës së Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Dhënave Personale për vitin 2015.

17. Votimi i raportit financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015

Lus regjinë dhe deputetët të përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 56 vota për, 8 abstenime dhe një kundër, Kuvendi e miratoi raportin vjetor financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2015.

18. Votimi i raportit të punës së Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2015

Lus regjinë dhe deputetët të përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 61 vota për, 5 abstenime, asnjë kundër, Kuvendi e miratoi raportin e punës së Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale për vitin 2015, bashkë me rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL.

19. Votimi i raportit të punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2015

Lus regjinë dhe deputetët të përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 53 vota për, 7 abstenime dhe 7 kundër, Kuvendi e miratoi raportin e punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2015.

20. Votimi i raportit vjetor të punës së Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2015

Lus regjinë dhe deputetët të përgatitemi për votim. Votojmë tash!

Konstatohet se me 62 vota për, 4 abstenime dhe 3 kundër, Kuvendi e miratoi raportin vjetor të punës së Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2015, bashkë me rekomandimet e Komisionit FunkSIONAL.

Të nderuar deputetë,

Me këtë i mbylлим punimet e kësaj seance dhe fillojmë me seancën e re.

*E përgatiti:
Njësia për Transkriptim dhe Lekturë*